

Revista "Karriera" është publikim i Qendrës për Zhvillim të Karrierës në Universitetin e Prishtinës. Ky është numri i katërt i revistës dedikuar informimit të studentëve për përgatitjet e nevojshme drejt punësimit, trendet në zhvillimin e profesioneve të caktuara dhe kriteret e tregut të punës. Revista shpërndahet falas për studentët, të diplomuarit dhe punëdhënësit. Përmbytja në artikuj nuk paraqet gjithmonë qëndrimet tona. Revista përfshin artikuj nga studentët, punëdhënësit, ekspertë vendorë e ndërkombëtarë, intervista, statistika, etj. Revista publikohet një herë në vit.

### Falënderojmë bashkëpunëtorët

#### Redaksia

Stafi i QZhK

#### Dizajni

Blerta Ademi

#### Lektor

Alfred Beka

#### Logo

Fjolla Halitaj

#### Stafi vullnetar

Ana Livia Berishaj

Blerta Ademi

Florentinë Rrustolli

Nderim Zuçaku

#### Kontakti

Qendra për Zhvillim të Karrierës  
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"

#### Adresa

Biblioteka Kombëtare e Kosovës, Kati i parë  
10000, Prishtinë

#### Email

[qzhk@uni-pr.edu](mailto:qzhk@uni-pr.edu)

Almira Ljaic  
praktikante në QZhK

Dea Dema  
praktikante në QZhK

Kastriot Demaj praktikant  
në QZhK

Ardi Mejzini  
Partneritet me Sektorin Privat  
për Forcimin e Arsimit të  
Lartë

Ideal Zhaveli  
Activism Roots

Jona Bregu, Pajtim Basha,  
Mensur Berisha, Dea  
Susuri  
Tango

Fjolla Shaqiri  
TOKA

Një falënderim i veçantë për *asst. dr. Elmedina Nikoçeviq-Kurti*, e cila me vizionin dhe përkushtimin e saj themeloi dhe nisi traditën e revistës "Karriera" në Qendrën e Zhvillimit të Karrierës. Kontributi i saj ka krijuar një platformë të rëndësishme, që frymëzon dhe mbështet të rinjtë në ndërtimin e së ardhmes së tyre profesionale.

Kjo revistë është një rekomandim i dalë nga Transformational Leadership Program – Scholarships and Partnerships, i cili është financuar nga USAID dhe Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë dhe implementuar nga World Learning.

Me një mirënjohje të thellë, falënderojmë *prof. ass. dr. Blerta Mustafa, shefe e Departamentit të Gjuhës dhe Letërsisë Angleze*, për kontributin e saj të jashtëzakonshëm në zhvillimin e studentëve dhe inkurajimin e tyre të angazhohen aktivisht në mundësi vullnetarizmi. Pjesëmarrja e saj aktive në ofrimin e mundësive për studentët për t'u bërë pjesë e Qendrës së Zhvillimit të Karrierës ka qenë një shtysë e madhe për rritjen e aftësiwe profesionale dhe personale të tyre.

Tel. +383 38 248 925/ 926

#### Ueb

[ekarriera.uni-pr.edu](http://ekarriera.uni-pr.edu)

LinkedIn

<https://www.linkedin.com/in/qendra-e-karrier%C3%ABs-up>

# PËRMBAJTJA

**Kalendari i aktiviteteve në UP**

Faqe 4

**Fjala e rektorit**

Faqe 5

**Statistikat e platformës “eKarriera”**

Faqe 6

**Aktivite për karrierë/ Industria në edukim**

Faqe 7

**Punëtorja për udhëzim në karrierë në Universitetin Ndërkombëtar Veror të Prishtinës**

Faqe 8

**Partneriteti me sektorin privat për forcimin e arsimit të lartë**

Faqe 9

**Programet e mentorimit**

Faqe 10

**Klubet studentore në UP: Ura lidhëse mes studentëve dhe industrisë**

Faqe 13

**Roli dhe rëndësia e zhvillimit të karrierës së të rinjve përmes punës vullnetare në Kosovë**

Faqe 15

**Rrënjët e vullnetarizmit: Ndryshojmë botën me zemërgjerësi**

Faqe 16

**Duke ndihmuar të tjerët, ndihmon veten - Ndikimi i vullnetarizmit në shëndetin mendor**

Faqe 17

**Activism Roots**

Faqe 18

**Përkujdesje ndaj të tjerëve - Edhe një ditë mund të bëjë ndryshim**

Faqe 19

**Programi i vullnetarizmit edukativ**

Faqe 22

**Angazhimi i parë në punë vullnetare: Pasiguritë më të zakonshme**

Faqe 23

**Vullnetarizmi si urë lidhëse mes rritjes personale dhe profesionale: Përvoja ime në Kosova English Teachers' Network (KETNET)**

Faqe 24

**Mundësi për punë vullnetarizmi në QZhK**

Faqe 25

**Roli dhe rëndësia e punës praktike**

Faqe 26

**Mundësi dhe statistika nga rrjeti Erasmus+**

Faqe 28

**Roli dhe rëndësia e zhvillimit të karrierës së të rinjve përmes mundësive të programeve të mobilitetit**

Faqe 31

**Fuqia e vullnetarizmit: Ndikimi global i organizatave dhe agjencive lokale**

Faqe 32

**Janet Reineck: Një jetë e frymëzuar nga Kosova dhe më tej**

Faqe 33

**Tituj librash mbi orientimin dhe zhvillimin në karrierë**

Faqe 34

**Fakte zbavitëse**

Faqe 36

**Bibliografia**

Faqe 37

**Qendra e Zhvillimit të Karrierës gjatë vitit të 17**

Faqe 38

**Gëzuar festat nga QZhK-ja!**

Faqe 39

# Kalendari i aktiviteteve në Universitetin e Prishtinës 2025

## Janar

Anëtarësimi në klubet e studentëve  
#klubetestudenteveup

## Shkurt

Shkëmbe përvojën, ndihmo të tjerët  
#UPTalkforsuccess

## Mars

Tryeza e rrumbullakët me tregun e punës, harmonizimi i kërkesave të tregut të punës me programet e studimit në UP  
#tryezaerrumbullakët

## Prill

Këshillimi për studime dhe teste standardizuese ndërkombëtare  
#LanguageUP

## Maj

Këshilla dhe rretëzim me punëdhënësit  
#karrieraUP

## Qershor

Promovimi i programeve studimore në UP  
#BehuUP

## Korrik

Universiteti Ndërkombëtar Veror i Prishtinës  
#PISU

## Shtator

Promovimi i programeve të punës vullnetare  
#VullnetarizmiUP

## Tetor

Dita e Orientimit UP  
#unejamUP

## Nëntor

Panairi i Edukimit "Studioni në Francë" Panairi i Punës, Karrierës dhe Ndërmarrësisë  
#PanairiUP

## Dhjetor

Promovimi i revistës "Karriera" (Nr.5)  
#revistakarriera

## FJALA E REKTORIT NË REVISTËN “KARRIERA”

*Të nderuar studentë,*

Secili e secila prej jush kur nis rrugën akademike në Universitetin e Prishtinës, në fund të saj, si mundësi shumë reale e të kapshme e sheh fillimin plot entuziazëm të një karriere të ndritshme e profesionale.

Revista „Karriera” e Qendrës për Zhvillimin e Karrierës, që po e nxjerr numrin e katërt, me ndihmën e një grupi të studentëve të Departamentit të Gjuhës Angleze, synon t’ju dërgojë drejt një pune të ëndrrave, të cilën gjithmonë kenë pasur dëshirë ta bëni, pa ndier lodhje dhe duke pranuar sfidat.

Unë, rektori, Arben Hajrullahu, kur shkruaj për revistën tuaj, nuk mund të mos kthehem në vitet e mia studentore, në atë kohë plot vullnet e energji, por edhe pamundësi, sfida e dëshirë për ta rizbuluar botën. Sepse, vetëm kështu arrij që t’ju kuptoj më mirë, e ndiej veten edhe shpirtërisht të barabartë me ju dhe si njëri prej jush.

Por nga përvoja ime jetësore, afërsisht dyfish më e gjatë se e juaja, paralelisht me krijimin e karrierës, ecjes përpara, rezultateve, sukseseve, fitoreve, mund t’ju them se nuk ka asgjë që ju plotëson më shumë sesa pasionet dhe puna vullnetare. Ajo nuk ka çmim, hap të gjitha dyert, çel të gjitha zemrat, të kthen te njeriu, te thelbi i vlerave të tij.

Puna vullnetare është ngjitëse në kuptimin e mirë të fjalës, mjafton ta bëni vetëm një herë, për ta bërë pastaj përgjithmonë.



Në këtë kohë të shumë fatkeqësive natyrore, ndryshimeve të papritura klimatike e luftërave, kur nuk dihet se çfarë sjell e ardhmja, të jeni pranë dikujt në nevojë, t’ia zgjasni dorën, është gjëja më e bukur dhe më madhështore që mund të bëni.

Puna vullnetare në terren mund t’ju shkëpusë pak edhe nga kthetrat e rrjeteve sociale dhe inteligjencës artificiale, që po na marrin aq shumë kohë e hapësirë, shpesh pavërejtshëm, sepse ashtu jemi mësuar.

Nuk është e domosdoshme të jeni pjesë e ndonjë organizate për të zhvilluar aktivitete vullnetare. Mjafton vetëm ta doni veten, tjetrin, vendin dhe të themi, derisa jeni duke ecur diku në natyrë, mund të mblihdhni mbeturinat e hedhura ose thjesht të dilni e të mbillni ndonjë dru, ndonjë lule, a të thoni me zë ndonjë fjalë të mirë.

Duken gjëra të vogla që nuk i sheh askush, por asgjë në këtë botë nuk kalon pa u vërejtur.

*I juaji,  
rektori i Universitetit të Prishtinës  
Arben Hajrullahu.*

# Statistikat e Platformës “eKarriera” gjatë 2024



137407 profile të studentëve dhe të diplomuarve në “e-Karriera”



70 aktivitete me qëllim aplikimi për pjesëmarrje



401 kompani / institucione në “e-Karriera”



300 shpallje për punësim



1062 studentë me CV të plotësuar në “e-Karriera”



68943 përfitues të aktiviteteve



201 aktivitete të organizuara



635 ndjekës në LinkedIn



95816 studentë pjesëmarrës në Platformën Virtuale të Panairit të Karrierës



1097 njoftime për studentët

## Aktivite për karrierë/ Industria në edukim

Gjatë vitit 2024, Qendra për Zhvillim të Karrierës në UP shënoi rritje të interesimit të studentëve, të diplomuarve dhe kompanive për të përfituar nga shërbimet që ajo ofron. QZHK-ja është e përkushtuar në ngritjen e mundësive dhe cilësisë së shërbimeve për ndërlidhjen e studentëve dhe të diplomuarve me tregun e punës, duke ofruar promovim të mundësive që punëdhënësit dhe institucionet e arsimit joformal kanë për ta. Aktivitetet që organizon QZHK-ja fokusohen në ofrimin e mundësive për rrjetëzimin e studentëve me punëdhënësit, angazhimin e studentëve në aktivitete ekstrakurrikulare si dhe zhvillimin e aftësive personale dhe profesionale të studentëve për aplikim në punë.

### "Praktika në SEMS", shtator 2024



Universiteti i Prishtinës ka krijuar modul inoativ "*Praktika në SEMS*", i cili synon të lehtësojë dhe të promovojë punën praktike për studentët dhe të diplomuarit. Ky modul shërben si urë lidhëse mes *studentëve të UP-së* dhe *tregut të punës*, duke ofruar mundësi për zhvillimin e kompetencave dhe aftësive jashtëkurrikulare në bashkëpunim me sektorin *publik dhe privat*. Përmes modulit "*Praktika në SEMS*", organizatat mund të publikojnë thirrje për praktika (me pagesë dhe pa pagesë), ndërsa studentët mund të aplikojnë drejtpërdrejt për këto mundësi. Platforma gjithashtu u mundëson punëdhënësve të identifikojnë kandidatët e duhur, duke filtruar profilet sipas programeve të studimit dhe *nivelit akademik (BA, MA, PhD)*. Disa nga komponentët kryesorë të modulit përfshijnë: *këshillimin, aplikimin, mentorimin, vlerësimin dhe certifikimin e praktikave të suksesshme*, duke garantuar një përvojë të plotë dhe të strukturuar për studentët në rrugëtimin e tyre profesional.

### Panairi i universiteteve franceze, nëntor 2024

Qendra për Zhvillim të Karrierës, në bashkëpunim me Fakultetin e Filologjisë dhe Alliance Française (AF), organizoi aktivitetin mbi ofrimin e informatave mbi mundësitë e studimit në universitete frankofone, duke përfshirë programe studimore, bursa dhe procedurat e aplikimit.




### Vizita studimore në tregun e punës në Universitetin e Prishtinës

Qëllimi i këtyre vizitave ishte rrjetëzimi dhe informimi nga afër me punën në institucione publike dhe private mbi kulturën organizative, të arriturat dhe sfidat e tyre. Ky aktivitet tradicional, i cili është pjesë e kalendarit vjetor "Vizitë në institucione dhe organizata", u organizua nga Qendra për Zhvillim të Karrierës dhe Dekanati i Fakultetit të Filologjisë, në bashkëpunim me partnerët nga tregu i punës.

### Këshillim dhe rrjetëzim me punëdhënësit

Aktivitetet tradicionale rrjetëzuese, të cilat organizohen nga Qendra për Zhvillim të Karrierës në Universitetin e Prishtinës, synojnë udhëzimin në karrierë dhe ndërlidhjen e studentëve dhe të diplomuarve të Universitetit të Prishtinës me tregun e punës. Përmes këtyre aktiviteteve, ofrohen këshilla nga punëdhënësit dhe mundësohet rrjetëzimi i studentëve e të diplomuarve me përfaqësues të institucioneve pjesëmarrëse. Sivjet janë realizuar prezantime nga dhjetë institucione pjesëmarrëse, si: *Viva Fresh Retail Academy, Global Engineer Girls (GEG), Ministria e Financave, TEB Bank, Administrata Tatimore e Kosovës (ATK), SPEEEX, American Advising Center, Kosovo Generation Unlimited, Young Cells Scheme, Teach for Kosova.*



## Punëtorja për udhëzim në karrierë në Universitetin Ndërkombëtar Veror të Prishtinës

Gjatë muajit korrik, studentët e **Universitetit Ndërkombëtar Veror të Prishtinës** u mblodhën në një punëtori të veçantë për udhëzim në karrierë, organizuar nga **Qendra për Zhvillim të Karrierës (QZhK)** pranë Universitetit të Prishtinës. Kjo ngjarje e rëndësishme, e mbajtur në **Bibliotekën Kombëtare të Kosovës "Pjetër Bogdani"**, shërbeu si një platformë për të ndihmuar pjesëmarrësit të bëjnë zgjedhje të informuara dhe të ndërtojnë strategji të qëndrueshme për të ardhmen e tyre profesionale.

Punëtorja u zhvillua si një kombinim i formatit fizik dhe online dhe zgjati dy orë, duke u fokusuar në nevojat e studentëve për të kuptuar më mirë opsionet e karrierës, për të identifikuar pikat e tyre të forta dhe për të ndërtuar një plan veprimi të qartë për avancimin në karrierë.

### Rëndësia e udhëzimit në karrierë në Kosovë

Shumë studentë dhe të diplomuar në Kosovë përballen me sfida të mëdha kur zgjedhin një drejtim profesional ose kur kërkojnë punësim pas përfundimit të studimeve. Një pjesë e tyre shpesh përfundojnë në fusha ku kërkesa është e ulët ose zgjedhin kurse që nuk përputhen me interesat e tyre, gjë që ndikon negativisht në performancën dhe kënaqësinë e tyre profesionale. Në një vend ku rinia përbën një përqindje të madhe të popullsisë, udhëzimi i duhur në karrierë është thelbësor për të siguruar që forca e re e punës të jetë e punësueshme, e përgjegjshme dhe, më e rëndësishmja, e lumtur.

### Temat kryesore të diskutuara

Punëtorja ofroi njohuri të rëndësishme mbi mënyrën e:

- Zgjedhjes së drejtë të një karriere.
- Identifikimit të pikave të forta dhe interesave personale.
- Përbaljes me proceset e pranimit dhe tregun e punës.
- Zhvillimit të aftësive thelbësore për sukses.
- Krijimit të një rrjeti profesional të fuqishëm.



### Përfitimet për pjesëmarrësit

Secili pjesëmarrës mori një *Raport Vlerësimi Personal* dhe një kopje të botimit të vitit 2023 të hulumtimit të QZhK-së, duke i pajisur ata me burime të vlefshme për planifikimin e karrierës.

Pjesëmarrësit e punëtorisë dolën me njohuri më të thelluara mbi mundësitë e ndryshme të karrierës dhe një vizion më të qartë për të ardhmen e tyre, duke shënuar një hap të rëndësishëm drejt suksesit profesional.



# PARTNERITET ME SEKTORIN PRIVAT PËR



## Partneritetet me sektorin privat transformojnë arsimin e lartë në Universitetin e Prishtinës: Fokus në Bujqësi dhe TIK

Në një nismë të filluar në prill 2023, Universiteti i Prishtinës bashkon forcat me aktivitetin "Partneritetet me Sektorin Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë," të financuar nga USAID. Kjo përpjekje e përbashkët, e udhëhequr nga Universiteti i AjoVës, në bashkëpunim me Universitetin Shtetëror të AjoVës dhe Qendrën e Arsimit të Kosovës (KEC), është një projekt pesëvjeçar që synon fuqizimin e universiteteve publike të Prishtinës, Pejës dhe Prizrenit për të bashkëpunuar ngushtë me liderët e industrisë. Qëllimi kryesor i aktivitetit është të pajisë studentët në sektorët e Bujqësisë dhe Teknologjisë së Informacionit (TIK-ut) me aftësitë dhe kompetencat e nevojshme për sukses në tregun e punës.

Një aspekt kyç i kësaj nisme transformuese është angazhimi për përmirësimin e mundësive për studentë ndaj mësimnxënies me përvojë.

Universiteti i Prishtinës, konkretisht Qendra e Karrierës dhe stafi akademik, është aktivisht i përfshirë në realizimin e këtij objekti. Specifikisht, ky aktivitet synon të fuqizojë studentët e Fakultetit të Bujqësisë dhe Veterinarisë (FBV) dhe Fakultetit të Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK), për të planifikuar dhe udhëhequr rrugëtimin e tyre në zhvillimin e karrierës përgjatë studimeve të tyre bachelor.



Punëtori mbi Bashkëpunimin mes Universiteteve dhe Industrisë, i zhvilluar për përfaqësues nga universitetet partnere dhe bizneseve të sektorit privat nga Dr. Daniel L. Clay, Këshilltar

# FORCIMIN E ARSIMIT TË LARTË

## Mundësitë e studentëve për mësimnxënie me përvojë

Aktiviteti *"Partneritetet me Sektorin Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë"* ofron një spektër mundësish për mësimnxënie me përvojë, të përshtatura për nevojat unike të studentëve në sektorët e synuar. Këto mundësi përfshijnë:

- **Trajnime online për shkathtësi të buta dhe punësim:** Module trajnuese online të përshtatura, që fokusohen në aftësitë themelore të komunikimit dhe gatishmërinë për punë, duke siguruar që studentët të jenë të përgatitur mirë për kërkesat e punëdhënësve të tyre të ardhshëm në industritë e tyre të zgjedhura.
- **Programe të mentorimit:** Këto programe janë të projektuara për të lidhur studentët me profesionistë të industrisë që mund të ofrojnë udhëzim, perspektiva dhe përvojë të vërtetë. Vlen të theksohet se të dy mentorët dhe të mentoruarit do të trajnohen paraprakisht mbi praktikat më të mira për mentorim efektiv, para se të përputhen me njëri-tjetrin.
- **Programe të punës praktike:** Programet e strukturuar të praktikës me kompanitë kryesore të Bujqësisë dhe Teknologjisë së Informacionit të Kosovës, të cilat kanë pajtuar të bashkëpunojnë me aktivitetin për t'u ofruar studentëve përvojë praktike brenda sektorëve të tyre të veçantë. Këto praktika shërbejnë si një urë mes teorisë akademike dhe zbatimit praktik, duke lehtësuar një kalim tërheqës në sferën profesionale.
- **Pjesëmarrje në klube studentore:** Mundësi për studentët për të marrë pjesë aktivisht në klube studentore, duke mundësuar rrjetëzim, shkëmbim dijesh dhe nisimat bashkëpunuese midis studentëve me synime të ngjashme.

Përmes mundësive të lartcekura, aktiviteti do të pajisë studentët e TIK-ut dhe Bujqësisë me një spektër të përvojave dhe angazhimeve që ata mund të dokumentojnë në portofolin e tyre profesional. Në përfundim të studimeve bachelor, pritet që studentët e angazhuar në aktivitet nga FBV-ja dhe FIEK-u të kenë një set të fortë aftësish, përvojash dhe të jenë të pozicionuar si profesionistë konkurrues në fushat e tyre të zgjedhura. Bashkëpunimi i Universitetit të Prishtinës me aktivitetin "Partneritetet me Sektorin Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë" paraqet një hap transformues në përputhje të arsimit me kërkesat e industrisë. Duke ofruar mundësi të përshtatura të përvojës së mësuar për studentët në fushat e Bujqësisë dhe TIK-ut, ky bashkëpunim synon të formojë një brez profesionistësh të pajisur për të përparuar në tregjet e punës dinamike dhe konkurruese.



### Trajnime online përmes Kosova LEARN

Gjatë muajve të fundit, ekipi i aktivitetit dhe Qendra e Karrierës nga Universiteti i Prishtinës kanë organizuar një seri sesionesh informuese për të njoftuar studentët rreth platformës së re të mësimit online, Kosova LEARN. Kjo platformë ofron dy kurse: *"Vetëvlerësim për Mësimnxënie me Përvojë"* dhe *"Përgatitja për Mentorim."*

Kursi i parë ndihmon studentët të rezonojnë rrugën e tyre të zhvillimit të karrierës, të planifikojnë aktivitete ekstrakurrikulare, që do t'u sjellin avantazhe në gatishmërinë për punë në të ardhmen. Kursi i dytë pajis studentët për të marrë pjesë aktivisht në programet e mentorimit, duke i bërë ata të përgatitur për ndërveprimet e tyre me mentorët në mënyrë strategjike.

Për detaje rreth programeve të mentorimit dhe regjistrimit në të dy kurset, ju lutemi shikoni broshurën në faqet vijuese. Kurset, secila duke zgjatur vetëm një-dy orë, janë të qasshme online për studentët dhe mund të përfundohen gjatë kohës së tyre të lirë. Nëse jeni student i FBV-së ose FIKE-ut, shfrytëzoni këto mundësi për zhvillimin e karrierës tuaj tanil!

Mësoni më shumë për shërbimet për studentë, duke vizituar zyrën e aktivitetit në kampusin tuaj universitar, që ndodhet në Bibliotekën Kombëtare, përballë Këndit Amerikan. Përndryshe, ju mund të regjistroheni online për informata më të detajuara (skanoni QR kodin ose vizitoni linkun: [bit.ly/40TNXIL](http://bit.ly/40TNXIL)).



# PROGRAME TË



## ABOUT Private Sector Partnerships to Strengthen Higher Education

Këto programe mentorimi mbështeten nga Aktiviteti Partnerizet e Sektorit Privat për Forcimin e Ansimit të Lartë, financuar nga USAID dhe i udhëhequr nga Universiteti i Iovës, në bashkëpunim me Universitetin Shtetëror të Iovës dhe Qendrën për Ansim të Kosovës. Qëllimi i Aktivitetit është të plotësojë hendeun mes bizneseve dhe universiteteve publike në Kosovë, duke siguruar që studentët si ju të jenë të gatshëm për tregun e punës në TIK dhe Buqësi.

### Activity's Objectives



1

Enhance students' analytical capabilities with labor market data.



2

Forge strong ties with the private sector for relevant curriculum development.




3

Enable student experiential learning and connections.



4

Cultivate demand-driven applied research via university-private sector partnerships.



## Rreth Programeve të Mentorimit



### Çfarë është një Mentor?

Një mentor është një profesionist i industrië i cili punon me një ose më shumë studentët në zhvillimin e karrierës së tyre, duke përfshirë krijimin e CV-së, intervistimin dhe eksplorimin e mundësive për zhvillim të karrierës.



### Çfarë është një i/e Mentoruar?

Një i/e mentoruar është një student/e që punon me mentorin e tij/saj për të vendosur dhe ndjekur qëllime që mbështesin zhvillimin e karrierës së të mentoruarit/ës.



### PËRFITIMET PËR STUDENTËT

- Udhëzime dhe mbështetje e personalizuar, e përshtatur për pikat e forta dhe interesat e vetë-identifikuara të studentëve.
- Ndajja e njohurive që bazohen në ekspertizën dhe përvojën e mentorit për t'i ndihmuar studentët të mendojnë dhe të zhvillohen.
- Mundësitë e rrjetimit që lidhin studentët me mentorët me përvojë dhe rrjetin e tyre, gjë që krijon potencial për mundësi karriere në të ardhmen.


## APLIKONI PËR PROGRAME TË MENTORIMIT SOT!

### DHE ZHVILLONI KARRIERËN TUAJ

Lidhuni me një profesionist të industrië dhe mësoni nga përvoja e tyre, për të definuar rrugën tuaj profesionale!

### Çfarë është një program mentorimi

Një program i mentorimit universitar është një aktivitet i strukturuar jashtëskollor që bashkon studentët me mentorët profesionistë për të mirat zhvillimin akademik, profesional dhe personal të studentit. Mentorët dhe të mentoruarit takohen dy herë në muaj për të arritur një grup qëllimesh të përcaktuara qartë.



## Si të Aplikoni?



HAPI 1

Regjistrohuni në aktivitetin Partnerizet e Sektorit Privat për Forcimin e Ansimit të Lartë, përmes QR-kodit. Mos harroni të tregoni interesin tuaj për mentorim kur ju kërkon formulari!



HAPI 2

Regjistrohuni në kursin "Vetëvlerësim për Mbrojtësit me Përvaj" në **Kosovo LEARN** përmes QR-kodit. Po sa të përfundoni këtë kurs do të fitoni çasje në kursin e dytë, "Përvojat për Mentorin (për student)". Përfundoni të dy kurset dhe fitoni distinktivë digital për të dytë.



HAPI 3

Asistenti/ja e juaj i/e programit do t'ju kontaktojë në lidhje me përzgjedhjen e Mentorit. Ju do të përthekohen me një mentor bazuar në fushën tuaj të studimit dhe interesave. Orari i juaj, angazhimi dhe kohëzgjatja do të përcaktohen në biseda me mentorin tuaj në mënyrë që të mos ndërhyjë në studimet tuaja.



HAPI 4

Fillori i mentorimit tuaj!

### KUSH ËSHTË I PRANUESHËM PËR MENTORIM?

Të gjithë studentët që janë të regjistruar në Fakultetet dhe Programet e Studimit në vijim:

#### Fakulteti i Inzhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike

- Elektronikë, Automatism dhe Robotikë
- Teknologji e Informacionit dhe Komunikimit
- Inzhinieri Kompjuterike dhe Software

#### Fakulteti i Buqësisë dhe Veterinarisë

- Prodhim shtazor
- Teknologji Ushqimore me Bioteknologji

# MENTORIMIT

## PROGRAMET E DISPONUESHME TË MENTORIMIT PËR TIK



**Auron Mejzini**  
Inzhinier i Dizajnit Dixhital  
Apple



**Laura Thaqi**  
Inzhiniere e Sigurisë Kibernetike  
Beritapp



**Fitim Halimi**  
Zhvilluesi i Harduerit  
SUITËn



**Elban Avdyta**  
Zhvillues i Softuerit  
Health Horizon



**Edona Haziraj**  
Kandidate për doktoraturë dhe asistente  
Vienna University of Technology



**Taulant Ymeri**  
Inzhinier Softuerik  
COMLINE Computer & Softwarelösungen SE



**Mensur Kosumi**  
Menaxher i Lartë i Marketingut Dixhital  
American National Standards Institute



**Besart Kuleta**  
Arkitekt i Softuerit  
Xogjta Group, Inc

## PROGRAMET E DISPONUESHME TË MENTORIMIT PËR BUJQËSI



**Bahtir Hyseni**  
Prof. Asoc. Teknologji Ushqimore  
University of Mitrovica



**Blerina Rexhepi**  
Specialiste për Mbrojtjen e Bimëve  
Freelance Consultant



**Ekrem Gjokaj**  
Prof. Asoc. Agro-Ekonomi  
IPARD Agency



**Ben Dida**  
Specialist i Resurseve Natyrore dhe Mjedisit  
Hybrid Agro



**Lavdiqe Sopi**  
Ekonomiste e Bujqësisë  
Women 4 Women



**Agran Halimi**  
Agro-Ekonomi, Teknologji Ushqimore  
Pestova Company



**Sadik Maloku**  
Prof. Asoc. Agro-Ekonomi  
Health Horizon

## KLUBET STUDENTORE NË UP:

Klubet studentore në Universitetin e Prishtinës po dëshmojnë sukses të jashtëzakonshëm, duke angazhuar studentët në iniciativa ekstrakurrikulare, që mbështesin zhvillimin e tyre profesional. Deri tani, janë formuar nëntë klube studentore: pesë në Fakultetin e Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike (FIEK) dhe katër në Fakultetin e Bujqësisë dhe Veterinarisë (FBV).

Krijimi i këtyre klubeve është rezultat i bashkëpunimit të Qendrës për Zhvillim të Karrierës me aktivitetin e USAID-it “Partneritetet me Sektorin Privat për Forcimin e Arsimit të Lartë”, të implementuar nga Universiteti i AjoVës, në partneritet me Universitetin Shtetëror të AjoVës dhe Qendrën e Kosovës për Arsim. Një nga objektivat kryesorë të këtij bashkëpunimi është ofrimi i mundësive për studentët në mësimnxënie praktike dhe përgatitjen e tyre për tregun e punës në industrinë e Bujqësisë dhe Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK). Mbështetja e klubeve studentore është vetëm një nga fushat e bashkëpunimit. Fushat e tjera të bashkëpunimit janë: (1) zgjerimi i partneriteteve të Universitetit të Prishtinës me sektorin privat, për të mbledhur të dhëna mbi nevojat e tregut, (2) rishikimi i kurrikulës dhe (3) nxitja e hulumtimeve shkencore, ku studentët nën mentorimin e profesorëve ofrojnë zgjidhje inovative për sfidat e kompanive private në Kosovë.

Gjatë vitit 2024, klubet studentore kanë treguar potencial të madh në ndërtimin e partneriteteve universitet-industri, duke shërbyer si ura lidhëse mes studentëve dhe kompanive private, duke organizuar ngjarje të suksesshme me liderë globalë të industrisë. Disa shembuj të këtyre iniciativave të klubeve studentore janë:

### 1. Google Developers Group:

Për herë të parë solli në Kosovë **Google DevFest**, një ngjarje e mbushur me punëtorë dhe ligjërata nga ekspertë ndërkombëtarë në fushën e programimit.



## URA LIDHËSE MES STUDENTËVE DHE INDUSTRIË

2. **CyberSpace Club:** Organizoi **“EX Machina: Capture the Flag”** në bashkëpunim me **Sentry** dhe **Tech Park Prishtina**. Kjo ishte një garë 24-orëshe, ku studentët nga mbarë Kosova u sfiduan në zgjidhjen e problemeve reale të sigurisë kibernetike.



4. **Amazon Web Services Club:** Në bashkëpunim me *Amazon Web Services*, organizoi punëtori dhe aktivitete edukative, duke ofruar mundësi për studentët të mësojnë teknologjitë e fundit të *Cloud Computing*.



5. **Diversifying Farms Club:** Organizoi punëtorinë e tyre të parë, të cilën e udhëhoqi ass. prof. *Kaltrina Berisha* mbi *Aminat Biogjene*. Kjo ishte një mundësi e mirë për studentët të zgjerojnë njohuritë e tyre mbi cilësinë dhe sigurinë ushqimore nga pikëpamja e teknologëve të ushqimit.



Këto klube përfaqësojnë një platformë të shkëlqyer për studentët, duke u ofruar atyre mundësi për të zhvilluar aftësitë profesionale, për të krijuar lidhje me liderët e industrisë dhe për t'u njohur me trendet dhe sfidat më të fundit në treg.

Për t'u anëtarësuar në një nga klubet ekzistuese ose për të krijuar një klub të ri, studentët mund të përdorin linkun në vijim ose të skanoni QR-Kodin më poshtë. Për më shumë, Qendra për Zhvillim të Karrierës është gjithmonë e gatshme t'ju ofrojë mbështetje dhe këshilla të detajuara në këtë drejtim.

Anëtarësohuni në klube ekzistuese apo formoni klube të reja këtu!

## Roli dhe rëndësia e zhvillimit të karrierës së të rinjve përmes punës vullnetare në Kosovë

Nga: *Dafina Turkeshi*, drejtoreshë e Business Development Group

*Në një shoqëri që ndryshon dhe zhvillohet vazhdimisht, puna vullnetare ka një rëndësi të veçantë në formimin dhe zhvillimin e karrierës së të rinjve, veçanërisht në kontekstin e Kosovës. Puna vullnetare në Kosovë, jo vetëm kontribuon në ndërtimin e vlerave shoqërore, por gjithashtu luan një rol kyç në rritjen profesionale dhe personale të të rinjve.*

Për të rinjtë e Kosovës, puna vullnetare ofron një mundësi unike për të mësuar dhe ndikuar në çështje sociale dhe zhvillimore në vendin e tyre. Duke angazhuar veten në projekte të ndryshme, ata mund të ndihmojnë në ndërtimin e një shoqërie më të drejtë dhe të barabartë. Kjo jo vetëm që i adreson disa sfida sociale, por gjithashtu edukon dhe sensibilizon të rinjtë rreth çështjeve të ndryshme që prekin komunitetin e tyre.

Pjesëmarrja në punë vullnetare është një mundësi e mirë për të rinjtë e Kosovës që të zhvillojnë një shumëllojshmëri të kompetencave që janë shumë të rëndësishme në tregun e punës.

Shkathtësi si puna në grup, menaxhimi i projekteve dhe komunikimi janë thelbësore për suksesin në çdo fushë karriere. Për më tepër, eksperiencia praktike që fitojnë nga kjo pjesëmarrje u jep të rinjve avantazhin konkurrues që kërkohet shpesh nga punëdhënësit.

Duke u angazhuar në punë vullnetare, të rinjtë e Kosovës ndërtojnë dhe zgjerojnë rrjetet e tyre profesionale. Këto kontakte mund të hapin rrugën për mundësi pune të reja, praktika në fushën e tyre dhe madje edhe mundësi për studime të mëtejshme. Një rrjet i mirë i kontakteve mund të jetë një burim i çmuar për karrierën e një të riu në të ardhmen.

Puna vullnetare sfidon të rinjtë të dalin nga zona e tyre e rehatisë dhe të përballen me realitete të ndryshme sociale dhe ekonomike. Kjo përvojë ndihmon në formimin e karakterit dhe rritjen e vetëdijes, duke i bërë ata më të përgjegjshëm dhe të ndjeshëm ndaj nevojave të komunitetit të tyre.



Në Kosovë, ku një pjesë e madhe e popullsisë përbëhet nga të rinjtë, angazhimi vullnetar mund të jetë një mjet i rëndësishëm për zhvillimin personal dhe profesional të tyre. Ajo jo vetëm që i ndihmon ata të marrin një rol aktiv në shoqërinë e tyre, por gjithashtu i përgatit për një të ardhme më të suksesshme dhe të kënaqshme në karrierën e tyre. Prandaj, inkurajimi dhe mbështetja e punës vullnetare duhet të jetë një prioritet për institucionet arsimore, organizatat joqeveritare dhe qeverinë e Kosovës.

Për të rritur efektivitetin dhe ndikimin e punës vullnetare për të rinjtë në Kosovë, një ide e mirë është të merren si shembull modelet e suksesshme nga vendet e zhvilluara, të cilat përfshijnë integrimin e punës vullnetare në sistemet arsimore dhe profesionale dhe nxitjen e partneriteteve mes sektorëve publikë, privatë dhe organizatave joqeveritare. Këto modele ofrojnë, jo vetëm kredi apo pikë shtesë për angazhimet vullnetare në kuadër të kurrikulave, por gjithashtu përdorin teknologjinë dhe mediat sociale për të promovuar dhe menaxhuar mundësitë vullnetare.

Adaptimi i tyre në Kosovë do të kërkonte zhvillimin e programeve arsimore që integrojnë punën vullnetare dhe ndërtimin e rrjeteve ndërinstitucionale për të ofruar mundësi më të gjerë vullnetare, duke ndryshuar mënyrën se si shoqëria shikon dhe vlerëson punën vullnetare si një pjesë të rëndësishme të kulturës dhe zhvillimit të të rinjve.

## Erënjët e vullnetarizmit: Ndryshojmë botën me zemërgjerësi

Blerta Ademi

Staf vullnetar në QZHK

A keni menduar ndonjëherë se si një veprim i vogël mund të sjellë ndryshime të mëdha? Në një botë të mbushur me sfida si ndryshimet klimatike, pabarazitë sociale dhe krizat humanitare, vullnetarizmi është një rrugë e drejtë për të bërë një ndryshim. Kjo vepër njerëzore jo vetëm që ndihmon komunitetet, por gjithashtu pasuron jetën tuaj me përvoja të reja dhe mendim të zhvilluar kritik.

### Cfarë është vullnetarizmi?

Në thelb, vullnetarizmi është dhënia e kohës dhe aftësive tuaja për një çështje pa kërkuar shpërblim financiar. Ai mund të shfaqet në forma të ndryshme, duke filluar nga ndihma për fqinjët deri te pjesëmarrja në projekte ndërkombëtare për ndihma humanitare ose mbrojtjen e mjedisit. Në të gjitha format e tij, vullnetarizmi krijon një lidhje të fuqishme me individëve dhe komuniteteve.

### Pse është i rëndësishëm vullnetarizmi?

Përfitimet e vullnetarizmit janë të shumta dhe ndikojnë si tek individi, ashtu edhe te shoqëria.

#### Për individin:

- Ndhmon në zhvillimin e aftësive të reja si ato të udhëheqjes, komunikimit dhe punës në grup.
- Përmirëson vetëbesimin dhe ndjenjën e përmbyshjes personale.
- Krijon mundësi për të ndërtuar lidhje të reja shoqërore dhe profesionale.

#### Për shoqërinë:

- Ndhmon në zgjidhjen e problemeve të përbashkëta, si ndihma për të pastrehët ose mbrojtja e mjedisit.
- Forcon ndjenjën e solidaritetit dhe krijon komunitete më të bashkuara dhe më të qëndrueshme.

### Vullnetarizmi në Evropë

Evropa ka një traditë të gjatë të vullnetarizmit dhe një strukturë të mirorganizuar për ta mbështetur. Në Evropë, vetëm 6.5% e njerëzve në moshë pune marrin pjesë në vullnetarizëm formal, ndërsa 14.3% ndihmojnë në mënyrë joformale (ASSAE, 2023). Kjo tregon se shumë më tepër njerëz angazhohen për të ndihmuar të tjerët pa ndonjë strukturë zyrtare, edhe pse shpesh kjo përpjekje mbetet e pavlerësuar.

### Struktura e vullnetarizmit në Evropë:

- **European Solidarity Corps:** Ky program mbështet të rinjtë që duan të marrin pjesë në projekte që përmirësojnë komunitetet lokale dhe ndërkombëtare.
- **Erasmus+:** Përveç shkëmbimeve akademike, ky program ofron mundësi për pjesëmarrje në projekte vullnetare.
- **Strategjia e Rinisë së BE-së 2019-2027:** Një iniciativë që fokusohet në angazhimin e të rinjve dhe fuqizimin e tyre përmes vullnetarizmit.

Evropa është një shembull i shkëlqyer i asaj se si vullnetarizmi mund të ketë ndikim pozitiv në shoqëri. Ja disa shembuj:

- **Projekte për mbrojtjen e mjedisit:** Në vendet nordike, vullnetarët kanë ndihmuar në reduktimin e ndotjes përmes iniciativave të riciklimit dhe mbrojtjes së pyjeve.
- **Ndhma humanitare:** Në Evropën Lindore, organizatat vullnetare kanë ndihmuar refugjatët dhe komunitetet në nevojë duke ofruar ushqim, strehim dhe edukim.
- **Projekte edukative:** Në Itali dhe Francë, vullnetarët kanë kontribuar në mësimin e gjuhëve për emigrantët, duke i ndihmuar ata të integrohen më mirë në shoqëri.



Si të bëheni pjesë e vullnetarizmit? Nëse dëshironi të përfshiheni, ja disa hapa që mund të ndiqni:

- Zgjidhni një kauzë që ju frymëzon:
  - Mbrojtja e mjedisit;
  - Ndhma për të moshuarit;
  - Edukimi i fëmijëve ose emigrantëve.
- Kërkoni mundësi në platforma të besueshme:
  - [European Youth Portal](#)
  - Organizata lokale dhe ndërkombëtare që ofrojnë mundësi vullnetarizmi.
- Përgatituni për të kontribuar:
  - Merrni trajnime të nevojshme.
  - Informohuni për rregullat dhe detyrimet që lidhen me projektin.

Vullnetarizmi është një mënyrë për t'i dhënë diçka mbrapsht komunitetit dhe për të ndikuar pozitivisht në botë. Ai është një akt që ju fuqizon, ju ndihmon të zhvilloheni dhe krijon një ndjenjë të përbashkët të qëllimit. Në një botë ku shpesh ndihemi të pafuqishëm përballë sfidave të mëdha, vullnetarizmi na kujton se çdo veprim i vogël ka rëndësi.

Mos prisni më gjatë – filloni sot dhe bëheni pjesë e ndryshimit! Botës i nevojitet energjia dhe përkushtimi juaj.



## Duke ndihmuar të tjerët, ndihmon veten - Ndikimi i vullnetarizmit në shëndetin mendor

Ana Livia Berishaj

Kur ndihmojmë të tjerët, shpesh harrojmë që në fakt jemi duke e ndihmuar edhe veten. Vullnetarizmi, në thelb, është një akt dashamirësie dhe përkushtimi dhe është e qartë që ndikimi i tij në shëndetin tonë mendor është i mahnitshëm. Gjatë punës vullnetare, personat e angazhuar përjetojnë një sërë ndjenjash që në të shumtën e rasteve i ndryshojnë ata si individ. Një nga ato është sensi i pëmbushjes. Të gjithë jemi në kërkim të pëmbushjes emocionale dhe shpirtërore dhe një nga mënyrat më të mira për ta arritur atë është vullnetarizmi.

Ajo shfaqet zakonisht kur jemi duke punuar me një ekip ose kur detyrat që jemi duke i realizuar kanë rezultate pozitive dhe ndikim të dukshëm e të shpejtë të një person, komunitet apo organizatë. Ndjenja e pëmbushjes është një nga gjërat e para që një vullnetar vëren te vetja ditët apo javët e para të punës vullnetare, pasi që është një detyrë ndryshe në krahasim me obligimet e tjera të përditshme.

Si rrjedhojë e ndjenjës së pëmbushjes, vullnetarët vërejnë një rritje të vetëbesimit dhe një perceptim më të këndshëm të imazhit që kanë për veten, pasi që ndihen të aftë dhe të vlefshëm. Zvogëlimi i ndjenjave të izolimit dhe vetmisë janë poashtu të dukshme, pasi që natyra e vullnetarizmit është të jesh i rrethuar me të tjerët.

Shkëmbimi i bisedave, përkujdesja ndaj njëri-tjetrit dhe dhurimi i dashurisë na japin një ndjesi përkatësie dhe forcojnë lidhjet tona shoqërore. Trajtimi i ankthit dhe depresionit është një benefit tjetër i vullnetarizmit që nuk përflitet shumë. Sipas studimeve, angazhimi në aktivitete të vullnetarizmit mund të ndihmojë në rritjen e hormoneve të lumturisë si serotonina dhe dopamina, duke ulur nivelet e stresit dhe duke promovuar një gjendje më stabile të mirëqenies ([Wilson, 2012](#)).

Duke ndarë përvojën time si vullnetare në konferencën e 10-të të KETNET-it dhe në American Corner Prishtina, këto aspekte pozitive do të dalin në sipërfaqe. Në KETNET, unë asistova pjesëmarrësit dhe prezantova një temë, që bashkë me grupin tim e kishim hulumtuar. Duke ndihmuar pjesëmarrësit me çfarëdolloj kërkesë që kishin, unë u ndjeva më e lidhur me ata dhe së bashku me vullnetarët e tjerë u krijua një atmosferë mbështetëse dhe bashkëpunuese.



Ndërsa gjatë prezantimit të temës sonë, ndjenja që kam pasur kur pashë të tjerët të frymëzuar nga puna jonë ishte e papërkrahshme. Të shihje se si ajo ndikonte te të tjerët më dhe një ndjesi të thellë krenarie. Në anën tjetër, në American Corner Prishtina, kam udhëhequr dy klube për një afat kohor prej disa muajsh dhe merrja pjesë në aktivitete të ndryshme. Kjo më ndihmoi të ndihesha pjesë e diçkaje më të madhe, duke krijuar lidhje me njerëz dhe duke ndarë ide të ndryshme. Gjithashtu, përvoja ime në vullnetarizëm më ndihmoi të zhvilloj aftësi të reja dhe të thelloj ndjenjën e empatisë, duke më bërë më të vetëdijshme për nevojat e të tjerëve.

Pavarësisht përfitimeve, vullnetarizmi mund të ketë edhe disa sfida. Angazhimi i tepërt mund të çojë në lodhje fizike dhe emocionale, veçanërisht kur nuk arrijmë të gjejmë një ekuilibër mes punës vullnetare dhe detyrave të tjera. Këto sfida emocionale bëhen më të mëdha, sidomos kur punojmë në mjediset toksike ose kur përballemi me situata stresuese. Megjithatë, është thelbësore të sigurohemi që të kemi kohë për t'u kujdesur për mirëqenien tonë.

Përfundimisht, edhe pse mund të ketë momente të vështira, përfitimet që sjell vullnetarizmi janë të mëdha. Vullnetarizmi nuk është vetëm për të ndihmuar të tjerët, por edhe për të forcuar lidhjet me ata që na rrethojnë dhe për të përmirësuar shëndetin tonë mendor. Prandaj, është e rëndësishme të vazhdojmë të angazhohemi dhe të promovojmë vullnetarizmin, duke e konsideruar atë si një mundësi për rritje personale dhe për të kontribuar për një shoqëri më të mirë.

# Activism Roots

Organizata Activism Roots është një organizatë e re, e cila është regjistruar në muajin mars të vitit 2021 dhe ka filluar funksionin në muajin maj 2021. Organizata është themeluar me synim që të promovojë dhe të rrisë aktivizmin qytetar në Kosovë. Selia e organizatës është në Gjakovë, ku edhe ka filluar punën dhe zyrën në Prishtinë.

Themelimi i organizatës është bërë nga aktivistë qytetarë të Gjakovës, të cilët kanë më shumë se 4 vjet përvojë në shoqërinë civile, duke menaxhuar projekte të ndryshme nga donatorë të ndryshëm. Mungesa e një organizate joqeveritare që ka për qëllim promovimin dhe nxitjen e qytetarisë aktive në rajonin e Gjakovës, ka sjellë nevojën që të kemi një organizatë në rajonin tonë që punon në këtë fushë.

Organizata jonë ka për qëllim të sjellë mënyrë të re të funksionuarit dhe një mentalitet ndryshe në rajonin tonë, por edhe një mënyrë të re se si të rinjtë mund të udhëheqin një organizatë joqeveritare që nxit dhe promovon aktivizimin në komunitet.

Adresa e zyrës kryesore: Rr. Ismail Qemajli, pa numër, 50 000 Gjakovë, Republika e Kosovës  
Numri i telefonit: 048124200  
WebFaqja: [www.activismroots.org](http://www.activismroots.org)

Activism Roots synon që qytetarët të përfshihen në vendimmarrje dhe të kërkojnë llogaridhënie nga institucionet për çështjet, për të cilat ne do të avokojmë dhe llobojmë.

Ne kemi për qëllim të sjellim mënyrë të re të funksionimit dhe një mentalitet ndryshe se si qytetarët mund të udhëheqin, nxisin dhe promovojnë aktivizimin në komunitet.

3 fushat kryesore ku organizata jonë fokusohet janë:

1. Qytetaria aktive/vullnetarizimi;
2. Të drejtat e njeriut;
3. Zhvillimi i të rinjve.

# Përkujdesje ndaj të tjerëve -

TANGOO NË TERRE DES HOMMES EXPERIENCE JOURNAL

Autorë: Punonjësit e Tangoo - Jona Bregu, Pajtim Pasha, Mensur Berisha, Dea Susuri

## tangoo

*A ju ndodh ndonjëherë të mendoni se nuk keni kohë për të bërë diçka të veçantë për të tjerët? Në një botë të mbushur me ngutje, ka momente që na kujtojnë gëzimin e thjeshtë dhe momentet e pastra që e bëjnë jetën të vlefshme.*

Një ditë vullnetarizmi me fëmijët në Qendrën Ditore për Fëmijë (Prishtinë) është një përvojë e tillë që na mbushi zemrat me ngrohtësi, shpresë dhe një ndjenjë të ripërtërirë qëllimi. Sot, ne ju ftojme të bashkoheni me ne në një udhëtim në botën e dhembshurisë dhe lidhjes, ndërsa fillojmë një ditë të kaluar me fëmijë që vlerësojnë gjërat që disa i marrin si të mirëqena - të tilla si vaktet e nxehta, kujdesi dhe vëmendja. Kjo ditë premtan të jetë një përzierje e lezetshme e të qeshurit, të mësuarit dhe dashurisë, ndërsa bashkohemi për të bërë një ndikim pozitiv në një ditë të këtyre qytetarëve të rinj të botës. Ndërsa zhytemi në këtë aventurë të ngrohtë, ne dëshmojmë fuqinë transformuese të kalimit të kohës me fëmijët, të qenit të pranishëm në moment dhe, nga ana tjetër, duke ushqyer shpirtat tanë.

Pra, le të zbulojmë magjinë e dhënies dhe qëndrueshmërinë dhe mrekullinë e jashtëzakonshme që fëmijët na mësojnë të sjellim në jetën tonë.

Tangoo ka disa vite që bashkëpunon me Terre Des Hommes, duke mbështetur projektet e tyre që synojnë të rrisin cilësinë e jetës dhe të shpëtojnë jetën e fëmijëve që vijnë nga situata të vështira sociale dhe familjare, në mbarë botën. Ne përpiqemi të përhapim mësimet tona të punës me TDH, në mënyrë që të mund të bëjmë një ndryshim pozitiv në jetën e fëmijëve në rajone të shumta dhe të lëmë një shenjë pozitive në mbarë globin.

- thotë **PAOLO FERRARA** nga **TERRE DES HOMMES ITALIA**.

Në Tangoo ne besojmë se të gjithë kanë aftësi dhe njohuri që mund të përdorin dhe pjesëmarrja e brendshme është e hapur në të gjitha nivelet për të kontribuar në drejtim të përgjegjësisë sociale.

Në fakt, çdo anëtar i ekipit mund të ndihmojë në disa projekte në orarin e tyre të punës; nëse kjo është duke përdorur njohuritë e tyre në mënyrë për të rritur ndërgjegjësimin ose për të shfrytëzuar njohuritë e marketingut për fushatat që synojnë të fitojnë mbështetje më të madhe për kauzat sociale.

Në terren, zhvillohen vazhdimisht programe të përbashkëta, për të trajtuar probleme të tilla si analfabetizmi dhe mungesa e lehtësive bazë, duke ofruar kujdes shëndetësor dhe arsim, duke punuar për të parandaluar dhunën dhe shfrytëzimin.

# Edhe një ditë mund



Kjo ishte një përvojë e jashtëzakonshme, një ditë e mbushur me lumturi dhe ekipi ynë e zbuloi me kënaqësinë e plotë të të gjithëve. Ne i mbështetëm me gjithë zemër mbikëqyrësit në detyrat e tyre të përditshme, nga ndihma në përgatitjet e vakteve deri te orkestrimi i një sërë lojërash tërheqëse. Të dëshmosh ndikimin e thellë të kontributit tonë modest në lumturinë e fëmijëve ishte vërtet emocionuese.

*Mensur Berisha,*  
Senior Campaign Executive



Këtë herë, të gjitha ekipet tona u takuan në dy qendra të Terre Des Hommes - në Milano dhe Prishtinë, në të njëjtën ditë, për të kontribuar në projektet e drejtuara në qytetet ku ndodhen zyrat tona.

Në Milano, stafi ynë ndihmoi me disa punë të mirëmbajtjes së ndërtesave dhe në Prishtinë, të gjithë nga ekipet lokale të Prishtinës dhe Tiranës morën pjesë aktive në një ditë të zakonshme të Qendrës Ditore krah për krah me kujdestarët.

Qendra Ditore është një vend ku ofrohen shërbimet ditore në baza ditore. Fëmija zgjedh shërbimet ose aktivitetet, në të cilat do të marrë pjesë. Qendra synon të ofrojë shërbime për plotësimin e nevojave elementare të fëmijës dhe familjes. Shërbimet përfshijnë: ushqime, lojëra, aktivitete edukative dhe psikosociale, këshillim profesional, seanca prindërimi pozitiv si dhe koordinim për menaxhimin e rasteve.

Ky model gjithashtu ofron një portë për fëmijët në sistemin e mbrojtjes së fëmijëve kur është e nevojshme dhe shërbimet publike si arsimi, shëndetësia, mbështetja psikosociale, etj. Qendra e Kujdesit Ditor kontribuon shumë në mbrojtjen e fëmijëve, të cilët mund të ndihen të mbështetur nga një staf me përvojë: punonjës socialë, psikologë, mësues mbështetës, koordinator i qendrës, kujdestare shtëpie.

Ne duam të përhapim angazhimin për kauzën e mirë, prandaj vendosëm të ndajmë përshtypjet nga përvoja vullnetare e ekipit tonë në Qendrën Ditore | Terre des hommes - Kosovë, për të frymëzuar të tjerët të bëjnë të njëjtën gjë ose të vendosin të dalin vullnetarë.



*Dea Susuri,*  
Graphic Design Assistant

Gjatë kohës që ishim vullnetarë në qendrën komunitare lokale, pata një përvojë të jashtëzakonshme përkrah kolegëve të mi. Një pjesë të konsiderueshme të kohës sime ia kushtova punës së bashku me një nga koleget e mia, duke përgatitur ushqim për fëmijët dhe nënat që frekuentonin qendrën. Një moment i veçantë dhe emocionues i gdhendur në kujtesën time ishte takimi im me këtë vajzë të re. Pavarësisht se jetonte në rrethana shumë sfiduese, ajo shfaqti vendosmëri dhe qëndrueshmëri të jashtëzakonshme, jo vetëm ndoqi shkollën, por edhe u angazhua në aktivitetet e qendrës, duke ushtruar bujari ndaj të tjerëve. Ajo që binte në sy ishte përkushtimi i saj për të kryer detyrat e shtëpisë, duke shfaqur jo vetëm dashamirësi, por edhe një dëshirë të vërtetë për të përvetësuar njohuri dhe aftësi të reja në vendosmërinë për të ndërtuar për vete një të ardhme më të mirë, të ndryshme nga historitë që mund të haste në mjedisin e saj të ngushtë. Përpjekjet tona të përbashkëta jo vetëm që ndihmuan objektivat e qendrës, por gjithashtu siguruan një përvojë personale përmbushëse për ne.

## të bëjë ndryshim



Të sjellësh buzëqeshje në fytyrat e fëmijëve është një gëzim i pashoq, që jehon thellë në përvojën njerëzore. Megjithatë, ka një ndjenjë të jashtëzakonshme përmbushjeje në ndriçimin e ditës së një fëmije që përballet me vështirësi që asnjë shpirt i ri nuk duhet të durojë. Deri vonë, nuk kisha pasur mundësi të merresha me fëmijët e pastrehë, kështu që nuk mund t'i kuptoja emocionet e përfshira. Megjithatë, kjo përvojë zbuloi ndikimin e thellë edhe të gjestit më të thjeshtë, si mësimi i një fëmije për të bërë një varkë origami. Ai theksoi se si momente të tilla mund të ndryshojnë ndjeshëm emocionet e tyre, duke theksuar fuqinë transformuese të ndjenjave, pavarësisht nga rrethanat. Pres me padurim rilidhjen me këta fëmijë të mrekullueshëm, duke u zhytur edhe një herë në gëzimin e pastër të aktiviteteve lozonjare.

*Pajtim Pasha,  
Senior Graphic Designer*

Një ditë vullnetarizmi me fëmijët është një kujtesë e fuqishme e potencialit të pakufishëm që gjendet brenda secilit prej nesh për të bërë një ndryshim, pavarësisht sa të rinj apo të moshuar mund të jemi. Kontributi i kohës dhe vëmendjes mund të jetë po aq i rëndësishëm sa mbështetja ekonomike. E qeshura, kurioziteti dhe pafajësia e këtyre fëmijëve japin një buzë shprese në një botë ndonjëherë komplekse.

Ndërsa përfundojmë ditën tonë, ne mbajmë me vete, jo vetëm kujtimet e buzëqeshjeve dhe aventurave të përbashkëta, por edhe besimin se përpjekjet tona të vogla mund të mbjellin farat e ndryshimit pozitiv për të ardhmen.

Pra, ndërsa i japim lamtumirën ditës sonë të vullnetarizmit, le të mbajmë mësimet që kemi mësuar, të qeshurat që kemi ndarë dhe dashurinë që kemi dhënë dhe marrë, duke i lejuar ata të na frymëzojnë të jemi ndryshimi që dëshirojmë për të parë në botë.

Në fund, janë veprimet e vogla të dhembshurisë dhe lidhjet që ne krijojmë, që mund të ndriçojnë rrugën drejt një të ardhmeje më të ndritshme për të gjithë.

# Programi i Vullnetarizmit Edukativ



**TOKA** është organizatë joqeveritare me mision përsheptimin e ndryshimit social në Kosovë, duke investuar në rininë e saj. Përmes programeve të edukimit joformal dhe formal, ne ndihmojmë të rinjtë e Kosovës të pajisen për t'u bërë agjentë të ndryshimit. Programet tona edukative dhe të zhvillimit rinor, të vërtetuara nga më shumë se **20,000 të rinj**, përdorin vullnetarizmin afatgjatë dhe të mësuarit përmes përvojës dhe u mundësojnë këtyre të rinjve të rriten. Ne jemi organizata lidere në vullnetarizëm në vend - me **1,000 vullnetarë** të angazhuar nga **6 deri në 12 muaj çdo vit**.

Programi i Vullnetarizmit Edukativ është programi më strategjik i TOKA-s, i cili prezanton një qasje pedagogjike joformale ndaj të mësuarit dhe integron shërbimin komunitar me udhëzimin dhe reflektimin. Ky proces pasuron përvojën e të mësuarit, mëson përgjegjësinë qytetare dhe forcon komunitetin.

Deri më tani, aktive kemi më shumë se **150 klube** të **super vullnetarëve**, të shtrira në më shumë se 70% të komunave të Kosovës. Klubet udhëhiqen nga **2-3 liderë**, të cilët mund të jenë mësues, studentë të psikologjisë ose edukimit, apo liderë të rinj. Këto klube mbledhin të rinj (**12-17 vjeç**) që dëshirojnë të mësojnë dhe të kontribuojnë në komunitetin e tyre me punë vullnetare. Ata takohen së bashku çdo javë për të identifikuar problemet e komunitetit, për të sjellë ide, për të planifikuar dhe për të implementuar projekte në komunitet.

Projekti vullnetar *Dita e Solidaritetit* në qendër ka të rinjtë të cilët punojnë në një biznes për një ditë dhe dhurojnë pagën e tyre për një kauzë të rëndësishme për ta. Udhëtimi i TOKA-s drejt zbatimit të këtij projekti për herë të parë në Kosovë filloi në **2022**, kur TOKA u bë organizata e parë kosovare kandidate anëtare e rrjetit **SAME**. Në qershor 2023, TOKA angazhoi **275 vullnetarë** në **6 ditë në 25 biznese** vendore dhe mbledhi një fond prej **4,332 euro**, i cili u nda në dy organizata që realizuan projekte në dy fushat - **shëndeti mendor i të rinjve (QHPSM)** dhe **fëmijët me aftësi të kufizuara (Down Syndrome Kosovo)**.

Përmes aktiviteteve interaktive, anëtarët e klubeve zhvillojnë shkathtësi të ndryshme si: mendim kritik, lidhshmëri, komunikim, zgjidhje të problemeve, punë në grup dhe rritje të vetëbesimit.

## Punë praktike në Programin e Vullnetarizmit Edukativ

Studentët e Departamentit të Psikologjisë të Fakultetit Filozofik mund të angazhohen në vëzhgimin e takimeve javore të Klubeve të Super Vullnetarëve në kuadër të orëve të praktikës.

Për më shumë na ndiqni në [Facebook](#) apo [Instagram](#).

### Adresa:

St. Meto Bajraktari, No. 4-1, 10000 Prishtina  
| [www.toka-ks.org](http://www.toka-ks.org) |  
+383 (0)38 704 560

# Angazhimi i parë në punë vullnetare: Pasiguritë më të zakonshme

**Florentinë Rustolli**  
Staf vullnetar në QZHK

Angazhimi në punë vullnetare është një mundësi që asnjë student nuk duhet ta anashkalojë. Shumica e njerëzve mendojnë se të jesh një vullnetar do të thotë të ofrosh ndihmë pa pasur ndonjë përfitim financiar (Ndreçka, 2018), duke mos i kushtuar rëndësi pjesës së përfitimeve jomaterialiste që sjell puna vullnetare për studentët e angazhuar.

Studentët, nëpërmjet punës vullnetare, përgatiten për një të ardhme më aktive dhe pasurojnë përvojën e tyre në fusha të ndryshme, përvojë kjo e domosdoshme për hapat e më tutjeshëm që studentët i ndërmarrin në jetën e tyre profesionale. Studentët, nëpërmjet punës vullnetare, pajisen me aftësitë e nevojshme për tregun e punës, duke u sfiduar në aspekte të ndryshme.

Për këtë arsye, studentët duhet të tregohen optimistë dhe të motivuar për një përvojë vullnetare sa më të suksesshme dhe përfituese. Mirëpo, shpeshherë ndodh që përvoja e parë me punë vullnetare të jetë më sfiduese për studentin dhe të shoqërohet me pasiguri që vijnë si shkak i mospërfshirjes së mëparshme në punë vullnetare, mungesës së vetëbesimit, ose edhe nga frika e mosbalancimit të angazhimeve vullnetare dhe atyre akademike, çështje këto që duhen adresuar.

Njëra prej situatave që shkakton pasiguritë e para të studentët kur përfshihen në punë vullnetare është mungesa e një përvoje të tillë të mëparshme. Kjo situatë pastaj shoqërohet me ndjenja negative si frika e mosadaptimit në një rol përkatës, ose edhe dyshimi në vetvete për të arritur përbushjen e detyrave të kërkuara. Kjo përballje shtyn një vullnetar të stepet dhe të mos përfitojë aq sa duhet nga një rol i caktuar. Mirëpo, mbështetja e vazhdueshme nga stafi vullnetar dhe koordinatori përkatës do ta lehtësojë procesin e adaptimit të studentit, si dhe do t'i mbyllë portat e shumë pasigurive të tjera që rrjedhin si pasojë e mungesës së përvojes së mëparshme vullnetare.

Ekziston gjithmonë hera e parë për çdo gjë dhe, duke pasur këtë parasys, studentëve vullnetarë duhet t'u jepet përkrahja e duhur në fillimet e tyre, në mënyrë që të mos hezitojnë nga ndjenjat e pasigurisë, por të japin më të mirën e tyre në punët përkatëse dhe në të njëjtën kohë të përfitojnë nga puna që bëjnë.

Angazhimi për herë të parë në punë vullnetare shoqërohet edhe me pasiguri që lidhen me vetëbesimin e vullnetarit. Rolet e reja dhe përgjegjësitë e mëdha të shoqëruara me këto role, bëjnë që studentit të humbë besimin se i posedon aftësitë dhe njohuritë e nevojshme për t'i kryer detyrat e caktuara që i besohen gjatë punës vullnetare.

Në anën tjetër, presioni për ta kryer një detyrë me sukses dhe ashtu siç pritret nga të tjerët, përbën një ngarkesë të madhe psikologjike për studentin. Kur ke mendjen e ngarkuar dhe ke frikë se mos dështon, ose vazhdimisht ke frikën se mos i zhgënjën personat që të besojnë, atëherë përfitimi nga puna vullnetare nuk do të jetë në nivelin më të lartë.

Për t'i ndihmuar vullnetarët në këtë aspekt, padyshim që ndihma dhe promovimi i vetëbesimit do të jenë me rëndësi primare. Dalja nga zona e komfortit mund të jetë e vështirë në fillim, por nëse je i vendosur ta bësh atëherë do ta kuptosh se ky ishte vendimi më i mirë që ke marrë ndonjëherë.

Një pasiguri tjetër mjaft e theksuar kur një student fillon punën vullnetare është pasiguria në balancimin e suksesshëm midis angazhimit në punë vullnetare dhe angazhimit akademik. Puna vullnetare kërkon dedikim dhe të konsumon një pjesë të mirë të kohës, kurse në anën tjetër studimet poashtu kërkojnë përkushtim të theksuar. Prandaj, shumë studentë që përfshihen për herë të parë në punë vullnetare mund të përballen me dy angazhime tejet përfshirëse dhe kontradiktore në aspektin e kohës.



Gjithmonë ekziston frika se angazhimi i tepërt në njërin prej fushave do të dërgojë deri në dështim në fushën tjetër, gjë që mund të ndikojë negativisht në performancën e vullnetarit. Studentët vullnetarë në këtë rast do të duhet të zhvillojnë aftësi të mira të menaxhimit të kohës së tyre dhe ta ndajnë kohën në një mënyrë efektive që do t'u mundësojë përfshirjen e duhur në secilin angazhim.

Aftësitë e menaxhimit të kohës janë të domosdoshme, pasi që ato mundësojnë një funksionim paralel të angazhimeve, duke i ndihmuar studentit vullnetar edhe në menaxhimin e stresit, që vjen si pasojë e kohës së limituar që mund ta ketë.

Në shoqërinë që po synojmë ta krijojmë, vullnetarizmi mbetet një proces i rëndësishëm dhe mjaft produktiv (Ndreçka, 2018). Pasiguritë janë të pranishme në çdo fillim të ri, mirëpo me mbështetjen e duhur mentoriale dhe grupore, studenti vullnetar mund t'i tejkalojë këto pasiguri më lehtë. Pavarësisht të gjitha sfidave që e presin një student, i cili ka vendosur të përfshihet në punë vullnetare, përfitimet personale dhe profesionale janë po aq të pranishme. Përfshirja aktive në punë vullnetare rrit gjasat për një karrierë më të suksesshme, pasi që individit pajiset me njohuri dhe aftësi nga më të ndryshmet, si dhe zhvillon aftësi të reja të punës grupore dhe individuale (Popja, 2021).

## Vullnetarizmi si urë lidhëse mes rritjes personale dhe profesionale: Përvoja ime në Kosova English Teachers' Network (KETNET)

**Nderim Zuçaku**  
Staf vullnetar në QZHK



Vullnetarizmi ka një ndikim të thellë dhe të jashtëzakonshëm në jetën e individëve dhe shoqërisë. Në përvojën time me Kosovo English Teachers' Network (KETNET), pata mundësinë të kontribuoj në forcimin e mësimdhënies së anglishtes dhe të mësoj shumë për veten time. Kjo përvojë më ka mësuar, jo vetëm për përfitimet që ofron vullnetarizmi për të tjerët, por edhe për ndikimin që ka në zhvillimin personal dhe profesional të individëve që janë të angazhuar në këtë lëmi.

Një nga momentet më të paharrueshme të vullnetarizmit tim ishte mundësia për të prezantuar një hulumtim që kisha zhvilluar. Ky moment më dha mundësinë të shfaqja dijen time dhe të ndihmoja mesimdhënësit e tjerë të anglishtes, duke ndarë informacione dhe praktika të reja që mund të ishin të dobishme për ta. Kjo ishte një mundësi për të rritur besimin tim në aftësitë profesionale dhe për të përmirësuar aftësitë e komunikimit dhe paraqitjes publike, një aftësi që është e rëndësishme për çdo profesionist. Siç e vërtetojnë studimet, vullnetarizmi mund të kontribuojë në zhvillimin e aftësive personale dhe profesionale (Wilson & Musick, 1999).

Përveç kësaj, pata mundësinë të udhëhiqja mysafirët gjatë aktiviteteve të ndryshme, një përvojë që më ndihmoi të zhvilloj aftësitë e udhëheqjes dhe të krijoj lidhje me mesimdhënësit të tjerë, të cilët më pas u bënë burime të vlefshme për zgjerimin e njohurive të mia.

Gjatë këtij procesi, kuptova më thellë se si vullnetarizmi mund të forcojë lidhjet sociale dhe të ndikojë pozitivisht në shëndetin mendor dhe emocional të individëve. Kjo është mbështetur edhe nga studime të tjera që tregojnë se vullnetarizmi ka një ndikim të madh në forcimin e lidhjeve sociale dhe përmirësimin e shëndetit mendor (Richards et al., 2019).

Përgjatë angazhimit tim në KETNET, pata mundësinë të takoj mesimdhënësit të rinj të anglishtes dhe të mësoj shumë prej tyre. Angazhimi në këto aktivitete më dha mundësinë të shoh se si mesimdhënësit të ndryshëm ofrojnë qasje të ndryshme në mesimdhënie dhe si mund të mësoj nga praktikat më të mira të tyre. Vullnetarizmi është një mundësi për të zgjeruar njohuritë dhe për të rritur aftësitë profesionale, një përvojë që mund të jetë thelbësore për zhvillimin e çdo individi në një mjedis edukativ (Okun et al., 2001).

Në fund, përvoja ime vullnetare në KETNET ka qenë një mundësi e jashtëzakonshme për të kontribuar në komunitetin edukativ dhe për të përmirësuar shëndetin dhe aftësitë e mia profesionale. Vullnetarizmi, siç e vërtetojnë studimet, është një mënyrë efikase për të ndihmuar individët dhe për të ndikuar pozitivisht në shoqëri (Okun et al., 2001). Unë jam mirënjohës për mundësinë që pata dhe do të vazhdoj të angazhohem në aktivitete të tilla, duke u falenderuar për mundësinë që kam pasur të kontribuoj dhe të mësoj kaq shumë gjatë këtij udhëtimi.





## UNIVERSITETI I PRISHTINËS "HASAN PRISHTINA" QENDRA PËR ZHVILLIM TË KARRIERËS

### MUNDËSI PËR PUNË VULLNETARE NË QZHK

Qendra për Zhvillim të Karrierës e Universitetit të Prishtinës është zyre e Administratës Qëndrore të UP-së që funksionon që nga viti 2007. Ofron shërbime të edukimit dhe udhëzimit në karrierë për studentët dhe të diplomuarit e UP-së. Organizon aktivitete të shumta që kanë për qëllim përgatitjen e studentëve për punësim dhe ndëlidhjen e tyre me tregun e punës.

Duke u bërë pjesë e stafit tonë, përveç që mësoni më shumë për profesionin e këshilltarit për karrierë, ju zhvilloni aftësitë tuaja administrative dhe organizative të cilat ju ndihmojnë të punësoheni më lehtë. QZHK ka rrjet të gjërë kompanish me të cilat bashkëpunon andaj keni mundësinë të takoni shumë përfaqësues të kompanive dhe të prezantoni vetveten e aftësitë tuaja.

## Hape derën e mundësive. Bëhu pjesë e stafit tonë!

Qendra për Zhvillim të Karrierës e Universitetit të Prishtinës ju fton të aplikoni për pozita të lira për punë vullnetare për periudhën tremujore (10 orë në javë). Këto janë pozitat e lira:

- Ndhmës administrator i platformës "e-Karriera"
- Dizajner i materialeve promovuese
- Ndhmës trajner
- Ndhmës në marrëdhënie me publikun

Të interesuarit ftohen të dërgojnë CV-në në emailin [qzhk@uni-pr.edu](mailto:qzhk@uni-pr.edu) duke cekur në subject të emailit pozitën për të cilën aplikojnë.

Qendra për Zhvillim të Karrierës  
Universiteti i Prishtinës "Hasan Prishtina"  
Adresa: Biblioteka Kombëtare e Kosovës,  
Kati i parë  
[qzhk@uni-pr.edu](mailto:qzhk@uni-pr.edu) [ekarriera.uni-pr.edu](mailto:ekarriera.uni-pr.edu)  
Tel: 038/ 248 925

248 926



# Roli dhe rëndësia e zhvillimit të karrierës së

## **Kastriot Dautaj**

*Student i Fakultetit Ekonomik,  
Banka dhe Financa*



Në një periudhë shumë të shkurtër, vendosa të vazhdoj studimet në fushën e ekonomisë, me theks të veçantë në departamentin Banka dhe Financa. Kjo zgjedhje vjen nga dëshira e thellë për të kuptuar se si zhvillohen proceset ekonomike dhe për të përparuar në aftësitë e nevojshme për analizat financiare. Gjatë viteve të mia të studimit, eksperiencat e arritura kanë rritur interesin tim për sektorin e financave.

Aktualisht, jam i përfshirë në role financiare në sektorin bankar, duke aplikuar njohuritë dhe aftësitë e fituara në këtë fushë. Synimi im është të vazhdoj të kontribuoj në këtë sferë dhe të zhvillohem në rrugën time profesionale.

Në tregun e sotëm dinamik, kalimi nga arsimi në fushën profesionale është një fazë kryesore për të rinjtë. Duke pranuar rëndësinë kryesore të përvojës praktike gjatë këtij tranzicioni, mundësitë që fokusohen te të rinjtë, si programet e punës praktike, janë bërë shtytësit kryesorë për zhvillimin personal dhe profesional.

Mentorimi gjatë këtyre programeve vepron si një forcë udhëzuese, duke ndihmuar pjesëmarrësit në lundrimin në ndërlikimet e industrisë së tyre të zgjedhur.

Programet e punës praktike funksionojnë si qendra rrjetëzimi, duke u mundësuar të rinjve të krijojnë lidhje me profesionistë, bashkëmoshatarë dhe mentorë. Këto lidhje shtrihen përtej kohëzgjatjes së programit, duke formuar një rrjet të fuqishëm profesional, i dobishëm në bashkëpunimet e ardhshme dhe mundësitë e karrierës. Këto programe sigurojnë që pjesëmarrësit të jenë, jo vetëm të aftë akademikisht, por edhe të aftë në trajtimin e sfidave të botës reale, duke rritur tërheqjen e tyre për punëdhënësit e mundshëm.

Fuqizimi i të rinjve përmes programeve praktike të punës përfaqëson një investim në suksesin e tyre në të ardhmen. Duke kapërcyer hendekun midis arsimit dhe punësimit, këto iniciativa krijojnë bazën për një fuqi punëtore të aftë, të adaptueshme dhe të lidhur mirë, e gatshme për të përmbushur kërkesat e botës profesionale.

# të rinjve përmes programeve të punës praktike

## Almira Ljaic

Praktikante në QZHK

Tri vitet e studimeve janë vite që do të mbahen mend gjatë. Presioni shtohet gradualisht kur je pranë përfundimit të tyre. Tranzicioni nga student në një person të përgatitur për t'u integruar në tregun e punës paraqet një periudhë jo shumë të lehtë, kërkon përkushtim dhe vendosmëri të madhe. Personalisht, për mua, kjo periudhë u bë më e lehtë përmes Qendrës për Zhvillim të Karrierës në Universitetin e Prishtinës.

Në vitin e fundit të studimeve, përmes kësaj qendre, e pashë një mundësi shumë të mirë për të kryer praktikën në Ambasadën Amerikane, më saktësisht në USAID, në Zyrën për Rritje Ekonomike. Gjatë këtyre 6 muajve, kam mësuar shkathtësi, të cilat do t'i mbaj mend gjatë dhe janë shumë të rëndësishme për secilën fazë të së ardhmes sime. Kjo periudhë praktike më ka mundësuar të kyçem më lehtë në tregun e punës, rrjetëzim dhe krijimin e kontakteve me njerëz të rëndësishëm në fushën time.

Jam njohur për së afërmi me proceset që duhet të kalohen gjatë zhvillimit të një projekti, duke filluar nga mbledhja e informatave të para e deri te rezultatet përfundimtare. Pjesëmarrja në evente të ndryshme dhe sfidat që komuniteti ynë dhe sidomos rinia përballet me to, kanë mundësuar që unë të jem më e vetëdijshme për to. Gjatë kësaj kohe, kam qenë e angazhuar edhe si vullnetare në Qendrën për Zhvillim të Karrierës, në rolin e asistentes për marrëdhënie me publikun. Puna me studentët dhe asistencë në krijimin e mundësive për workshop dhe seminare të ndryshme, që janë në interesin e tyre, më ka dhënë një ndjenjë të mrekullueshme, pasi që ishte e sinkronizuar pikërisht me atë që studentët po kërkonin.



Pra, në të njëjtën kohë, kam pasur fatin të jem në një pozitë që më ka lejuar të shoh mangësitë dhe përparesitë e rinisë nga dy perspektiva të ndryshme. Këtë periudhë e konsideroj si më të rëndësishmen deri tani në aspektin profesional, si një mundësi të vlefshme për t'u integruar në tregun e punës.

Edhe tani, pas përfundimit të dy eksperiencave, vazhdoj të jem e përfshirë në këtë fushë dhe me ndihmën e rrjetit dhe kontakteve të krijuara, e kam më të lehtë për të qëndruar e informuar për çdo zhvillim që është në interesin tim.

Njerëzit që kam takuar gjatë kësaj kohe kanë bërë edhe më të lehtë punën time në përgatitjen e punimit të diplomës, pasi kam mundur të grumbulloj të dhëna aktuale dhe të gjitha informacionet e nevojshme për ta përfunduar atë.

Nga eksperiencia ime, e shoh si të domosdoshme që studentët të fillojnë rrugën drejt suksesit që nga koha e studimeve dhe përfshirja në punë vullnetare është një hap i rëndësishëm drejt një karriere të suksesshme. Çdo angazhim jashtë fakultetit ka vlerën e vet, jo vetëm për përfitimet personale, por edhe për të ndikuar në mënyrë pozitive në komunitet dhe për ta përmirësuar atë.

# MUNDËSI DHE STATISTIKA

Mimika Dobroschi

Koordinatorë/ Shefe e Zyrës Kosovare Erasmus+

Programi Erasmus u krijua në vitin 1987 dhe është ndër programet më të njohura të BE-së në arsim dhe trajnim. Gjatë vitit të parë, vetëm 3,244 studentë shkuan jashtë vendit nga 11 vende të BE-së - Belgjika, Danimarka, Gjermania, Greqia, Franca, Irlanda, Italia, Holanda, Portugalia, Spanja dhe Mbretëria e Bashkuar.

Viti i kaluar shënoi 35 vjetorin e programit Erasmus+, një program që është përpjekur, për dekada të tëra, të rrisë përvojat e të mësuarit përtej kufijve dhe kontinenteve. Programi Erasmus+ promovon lëvizshmërinë mësimore të individëve dhe grupeve, si dhe bashkëpunimin, cilësinë, përfshirjen dhe barazinë në nivel organizatash dhe politikash. Ai mbulon arsimin dhe trajnimin e lartë; fushën e rinisë; promovon lëvizshmërinë mësimore të stafit, si dhe bashkëpunimin, cilësinë, përfshirjen në nivel të organizatave sportive dhe politikave sportive.

Në vitin 2005, kur unë studioja në Bruges në Belgjikë, çdo student evropian kishte një histori Erasmus nga vitet e tij të kolegjit, gjithmonë me një gjuhë që e mësoi ndërsa ishte jashtë vendit. Duke dëgjuar për herë të parë për këtë program, u ndjeva e frymëzuar dhe në të njëjtën kohë ziliqare, pasi ne nuk kishim mundësi të tilla për lëvizje akademike dhe studentore në pjesën tonë të Evropës.

Shpejt në vitin 2014, kur edhe në Kosovë u vu në dispozicion njëfarë akses, përmes Erasmus+, i cili deri më sot është rritur si në vëllimin e temave të mbuluara (arsimi i lartë, trajnimi, rinia dhe sportet) ashtu edhe në madhësi - duke u shtrirë përtej kontinentit tonë gjeografik.

Sipas Komisionit Evropian, mbi 12 milionë të rinj kanë përfituar nga programi Erasmus+ deri më sot, duke përvetësuar aftësi dhe gjuhë, duke krijuar miqësi, partneritete dhe duke hapur mendjet. Studimet e fundit kanë treguar se Erasmus+ ndikon pozitivisht në cilësinë e jetës dhe perspektivat e karrierës së studentëve - gjatë kursit të tyre jashtë vendit dhe shumë kohë më pas.

Programi është treguar se nxit inovacionin dhe përfshirjen sociale në arsimin e lartë. Më e rëndësishmja, i ndihmon studentët të zbulojnë se çfarë duan të bëjnë pasi të diplomohen.

Sa u përket statistikave në Kosovë nga viti 2015-2022, mbi 5000 studentë dhe staf akademik kanë shkuar në Evropë dhe më shumë se 2000 kanë ardhur në Kosovë përmes aksionit ndërkombëtar të mobilitetit kreditor të programit Erasmus+.

Deri në vitin 2022, institucionet e arsimit të lartë në Kosovë kanë fituar 50 projekte për Ngritjen e Kapaciteteve në fushën e Arsimit të Lartë, 4 projekte Jean Monnet, 2 projekte Erasmus Mundus Joint Masters. Nga viti 2021, ka pasur 1 projekt Erasmus Mundus Design Measures dhe nga viti 2015-2022, 41 Bursa të Përbashkëta Master Erasmus Mundus janë dhënë për studentët nga Kosova. Vetëm në vitin 2023 në arsimin e lartë ishin 13 fitues të projekteve me 27 institucione përfituese nga Kosova.

Projektet e Ngritjes së Kapaciteteve në fushën e Arsimit dhe Aftësitimit Profesional, Rinisë dhe Sportit janë aksione të reja të hapura për Kosovën që nga viti 2021 dhe tashmë po shohim fitues të shumtë të projekteve nga këto aksione në dy vjetet e fundit.

Për sa u përket mundësive të karrierës pas Erasmus - Në Bashkimin Evropian janë kryer studime ku një ndryshim dramatik në vitet e fundit perceptohet në qëndrimin e punëdhënësve ndaj përvojës ndërkombëtare. Sot 51% e punëdhënësve e konsiderojnë përvojën ndërkombëtare një faktor të rëndësishëm në zgjedhjen e punonjësve. 30% e konsiderojnë atë një kërkesë bazë për punën.

Studimet tregojnë se 85% e studentëve të Erasmus shkojnë jashtë vendit pjesërisht për të përmirësuar shanset e tyre për punësim dhe këto shifra na tregojnë se ata po bëjnë një zgjedhje të mençur.



Aq i vlefshëm është një vendosje Erasmus në CV-në tuaj saqë të gjithë punëdhënësit e konsiderojnë të dëshirueshme. Përvoja ndërkombëtare qëndron në krye dhe për shumë studentë, Erasmus, me strukturën e tij të financimit, mund të jetë mënyra e vetme për të fituar këtë përvojë.

Sipas Studimit të Ndikimit Erasmus, përfitimti i këtij programi ka një ndikim të madh afatgjatë në të ardhmen tuaj.

Pas pesë vjetësh, shkalla e papunësisë në mesin e të diplomuarve të Erasmus është 23% më e ulët se në mesin e kolegëve të tyre të diplomuar që nuk kanë shkuar jashtë vendit. Ata gjithashtu kanë më shumë gjasa të kenë kaluar në studime të larta. Edhe pas dhjetë vjetësh, të diplomuarit e Erasmus kishin akoma më shumë gjasa të punësoheshin sesa kolegët e tyre.

Sipas studimeve Erasmus gjithashtu ju ndihmon të ngriheni në një nivel më të lartë në karrierën tuaj. Pas pesë vjetësh tashmë kishte një rritje të numrit të njerëzve në pozicione menaxheriale, 57% kundrejt 53% në mesin e atyre që nuk bënë një vendosje Erasmus, por shumë më mbresëlënëse, pas dhjetë vjetësh 77% e studentëve Erasmus ishin në role drejtuese, plot 20% më shumë se mes bashkëmohatarëve të tyre.

# NGA RRJETI Erasmus +

Në një botë ku krijimi i punës suaj mund të jetë rruga më e mirë e karrierës, studentët Erasmus përsëri u dalluan. 7% e studentëve të Erasmus filluan bizneset e tyre, që është një përqindje shumë e lartë për të sapodiplomuarit. Mbi 40% mund ta shihnin veten duke e bërë atë dhe 30% kishin plane të caktuara për ta bërë këtë, që përsëri është një numër i madh.

Ka pasur edhe anketa të bëra vitet e kaluara me të diplomuarit e Erasmus në Ballkanin Perëndimor, ku shumica e tyre thanë se e kishin më të lehtë të gjenin një punë në krahasim me kolegët e tyre që nuk kishin dhe përvojën e Erasmus. Nga ky studim, kur është fjala për Kosovën, 40% e të anketuarve alumni kosovarë janë të punësuar dhe nuk studiojnë më, dhe 8% janë duke kërkuar punë. Ata shpesh punojnë në një universitet. Ndërsa shumica (80%) janë të punësuar në rajonin e Ballkanit Perëndimor, rreth një në shtatë (14%) punon në një vend të BE-së dhe vetëm një pjesë e vogël (3%) udhëton ndërmjet këtyre rajoneve.

Ka një ndikim të madh të përvojës së studimit jashtë vendit në situatën e punës së të diplomuarve të Erasmus. Vlen të përmendet se gjysma e të gjithë të intervistuarve kosovarë të punësuar tregojnë se e kanë punën e tyre aktuale për shkak të shkathtësive të fituara gjatë studimeve jashtë vendit.

Akoma më shumë thonë se njohuritë dhe aftësitë e fituara gjatë studimeve jashtë vendit i përdorin në punën e tyre aktuale (65%).

Profesionistët kosovarë më shpesh raportojnë një mospërputhje vertikale sesa një mospërputhje horizontale, d.m.th. ata ndjehen më shpesh të kualifikuar për punën e tyre sesa mendojnë se fusha e tyre e studimit nuk i përshtatet punës së tyre. Tre të katërtat (74%) e të anketuarve alumni nga Kosova tregojnë se janë të kënaqur me punën e tyre, që është mbi mesataren në kontekstin rajonal.

Duke qenë se viti 2023 është Viti Evropian i Aftësive, Zyra e Kosovës Erasmus+ ka punuar ngushtë me partnerët e saj evropianë dhe vendorë në Kosovë përmes promovimit dhe dialogut, duke u fokusuar në promovimin e veprimeve të programit Erasmus+ të cilat kanë ndihmuar të diplomuarit e saj në fitimin e aftësive të vlefshme të nevojshme për tregun e punës.

Kosova, duke pasur popullatën më të re në Evropë, nisma të tilla kanë një ndikim të madh për të rinjtë tanë - fuqizimin, lidhjen dhe zgjerimin e horizontit të tyre përmes mundësive të nënkuptuara në programin Erasmus+ si dhe duke ofruar aftësi të reja të vlefshme për integrimin e tyre të ardhshëm në tregun e punës.

Veprimet Erasmus+ të hapura për Kosovën janë si më poshtë:

- **International Credit Mobility**
- **Erasmus Mundus Joint Masters**
- **Erasmus Mundus Design Measures**
- **Capacity Building in the field of Higher Education**
- **Capacity Building in the field of Vocational Education and Training**
- **Capacity Building in the field of Youth**
- **Capacity Building in the field of Sport**
- **Jean Monnet**
- **Virtual Exchange**

Nëse dëshironi të aplikoni për ndonjë nga veprimet e lartpërmendura, ju lutemi vizitoni faqen e internetit të Zyrës Kosovare Erasmus+:

**[www.erasmuspluskosovo.org](http://www.erasmuspluskosovo.org)**  
**Për më shumë informacion, mund të konsultoni Erasmus+ Guide 2024 në lidhjen e mëposhtme:**  
**[2024-Erasmus+Programme-Guide\\_EN.pdf \(europa.eu\)](#)**

*Ju gjithashtu mund të na ndiqni në Facebook, LinkedIn dhe Instagram nën Zyrën Erasmus+ në Kosovë ose na shkruani në [office@erasmuspluskosovo.org](mailto:office@erasmuspluskosovo.org).*



## Roli dhe rëndësia e zhvillimit të karrierës së të rinjëve përmes mundësive të programeve të mobilitetit

Dea Demi

University Paris Nanterre, Law, Erasmus+

*Në një botë që po ndryshon çdo ditë, zhvillimi i karrierës së rinisë kërkon më shumë sesa vetëm arritjet akademike.*

Ajo kërkon njohuri të kulturave të ndryshme, aftësi për t'u adaptuar në mjedise të ndryshme të punës dhe aftësi tjera përtej kufijve të arsimit tradicional dhe jetës tradicionale.

Programet e mobilitetit për rininë lehtësojnë krijimin e një rrjeti ndërkombëtar, duke mundësuar bashkëpunimin me individë nga sfera të ndryshme.

Si një studente e cila aktualisht është pjesëmarrëse në programin Erasmus+, mendoj që ky program shërben si hyrje në një botë të mundësive, duke iu ofruar studentëve si unë një shans për t'u zhytur në mjedise të ndryshme kulturore, akademike dhe profesionale.

Jeta dhe studimi në vendet e huaja e përball individin në situata të reja dhe zhvillon aftësitë e adaptimit, aftësitë e komunikimit ndërkulturor dhe një perspektivë globale - cilësi që po bëhen gjithnjë e më të rëndësishme.

Duke qenë pjesë e këtij programi, nuk jam thjesht duke studiuar jashtë vendit, por po formoj aktivisht rrugën time në karrierë.



Kjo eksperiencë ofron një pikëpamje unike, duke mundësuar orientimin në përpjekjet e ardhshme karshi karrierës me një kuptim më të gjerë të tregut global.

Eksperiencia në këtë program është e pazëvendësueshme. Më ka lejuar të njoh perspektivat e personave të vendeve të ndryshme, të cilat jo vetëm që më kanë ndihmuar në anën profesionale, por më kanë ndihmuar edhe të rritem si person, duke i analizuar situatat, ngjarjet dhe mendimet në shumë pikëpamje.

Do të jem gjithmonë mirënjohëse për mundësinë që më është dhënë.

## Fuqia e vullnetarizmit: Ndikimi global i organizatave dhe agjencive lokale

Organizatave dhe agjencitë e njohura ndërkombëtare dhe lokale luajnë një rol të rëndësishëm në promovimin e vullnetarizmit, duke frymëzuar individët të kontribuojnë për kauza që ndikojnë pozitivisht në shoqëri dhe mjedis. Përmes projekteve të tyre, ato ofrojnë mundësi për zhvillimin personal dhe profesional të vullnetarëve, ndërkohë që përmbushin objektiva madhore si ndihma humanitare, edukimi, mbrojtja e natyrës dhe përfshirja sociale. Këto iniciativa ndihmojnë komunitetet në nevojë dhe forcojnë ndjenjën e solidaritetit global. Disa nga organizatat që bëjnë thirrje për vullnetarizëm janë:



### **United Nations Volunteers (UNV):**

Program global që mobilizon mijëra vullnetarë për të mbështetur zhvillimin e qëndrueshëm dhe paqen në mbi 150 vende.

### **Caritas:**

E pranishme në Kosovë dhe në botë, Caritas ndihmon komunitetet në nevojë përmes projekteve të zhvillimit dhe ndihmës emergjente.



### **Habitat for Humanity:**

Përmes projekteve të ndërtimit të shtëpive, kjo organizatë u ofron familjeve në nevojë një jetë më të qëndrueshme dhe përfshin vullnetarë nga e gjithë bota.

### **Kryqi i Kuq (Red Cross and Red Crescent Movement):**

Një organizatë humanitare globale që mbështetet në vullnetarë për të ofruar ndihmë emergjente dhe edukim për shëndetin.



### **YMCA:**

Duke vepruar në nivel lokal dhe global, YMCA mbështet të rinjtë përmes programeve të edukimit dhe zhvillimit personal.

### **SOS Fshatrat e Fëmijëve:**

Me fokus në mbështetjen e fëmijëve pa kujdes prindëror, kjo organizatë ka projekte aktive në Kosovë dhe globalisht.



### **Islamic Relief:**

Një organizatë humanitare me prani globale dhe në Kosovë, Islamic Relief punon për të ndihmuar komunitetet në nevojë përmes projekteve humanitare dhe zhvillimore. Ata inkurajojnë vullnetarizmin në fusha si ndihma emergjente, arsimit dhe zhvillimi ekonomik.



## Janet Reineck: Një jetë e frymëzuar nga Kosova dhe më tej

Janet Reineck, një antropologe dhe punonjëse humanitare, jetoi dhe punoi në Kosovë për tetë vjet, nga viti 1981 deri në 1997. Jeta dhe puna e saj janë thellësisht të lidhura me shqiptarët e Kosovës, të cilët ajo i përshkruan me dashuri dhe respekt të jashtëzakonshëm. Përmes një kujtese të ndërjeh dhe personale, Reineck ndan përvojat e saj të jetesës në fshatrat e Kosovës, duke krijuar një urë midis traditave të lashta dhe botës moderne.

### Frymëzimi nga Kosova

Janeti përshkruan jetën tradicionale shqiptare me detaje prekëse: vallëzimi me vajzat e fshatit, përgatitja e flisë me fqinjët, larja e flokëve me një kovë uji dhe bisedat pranë zjarrit me të moshuarit e urtë. Këto momente e ndihmuan atë të kuptonte thellë kulturën dhe shpirtin e popullit shqiptar. Kujtimet e saj janë një pasqyrë intime e një mënyre jetese që sot është zhdukur në masë të madhe. Kujtimet e Reineck janë shkruar për dy audiencë kryesore: të huajt që duan të kuptojnë më shumë rreth shqiptarëve dhe traditave të tyre, dhe vetë shqiptarët, të cilët përmes këtyre rrëfimeve mund të rikthehen në traditat e tyre ose të njohin rajone që mund të mos i kenë vizituar kurrë.

### Studime dhe kërkime në Kosovë

Në vitet 1981-1983, Reineck kreu kërkime për temën e saj të Masterit në Universitetin UCLA, ku u përqendrua në traditat e dasmave dhe vallëzimeve shqiptare në rajonin e Opojës. Më vonë, për doktoratën në Universitetin e Berkeley-t, ajo hulumtoi strukturën sociale dhe botëkuptimin shqiptar, duke analizuar ndikimin e migrimit në komunitetet lokale. Disertacioni i saj, "The Past as Refuge: Gender, Migration, and Ideology Among the Kosova Albanians", është një studim i detajuar mbi këto tema.

<https://www.janetreineck.com>



### Puna humanitare dhe ndikimi në Kosovë

Në vitin 1994, Reineck u kthye në Kosovë me djalin e saj, Jeremy, për të udhëhequr projekte zhvillimi rural në rajonet e Vitisë dhe Gjilanit për organizatat Oxfam dhe International Rescue Committee. Në bashkëpunim me ekipin e saj shqiptar, ata ndihmuan komunitetet lokale duke ndërtuar shkolla, gërmuar puse për ujë të pastër dhe përmirësuar kushtet sanitare. Përmes grupit të aktivisteve të reja "Legjenda," ata organizuan kurse mbi edukimin shëndetësor dhe inkurajuan vajzat të vazhdonin shkollimin.

### Jeta pas Kosovës dhe angazhimet e tjera

Në vitin 1997, me luftën që po afronte, Janet dhe djali i saj u detyruan të largoheshin nga Kosova. Ata u vendosën në Santa Barbara, Kaliforni, ku ajo nisi të punonte për organizata humanitare lokale. Në vitin 2010, Janet ndërthur pasionin për vallëzimin dhe ndihmën humanitare, duke krijuar organizatën World Dance for Humanity, e cila mbështet komunitete në Ruandë.

### Trashëgimia e dokumentuar

Gjatë viteve 1980, Janet regjistroi mbi 4,000 fotografi, 25 orë filmime dhe intervista të shumta me shqiptarë të Kosovës. Përmes tyre, ajo dokumentoi një mënyrë jetese që ndryshoi përgjithmonë pas luftës së vitit 1999. Sot, Kosova është një komb i ri që përballet me sfida për njohje ndërkombëtare, barazi gjinore dhe stabilitet ekonomik.

### Një mesazh falënderimi

Kujtimet dhe puna e Janet Reineck janë një shprehje e mirënjohjes së saj të thellë për shqiptarët dhe kulturën e tyre. Ajo u ka ofruar lexuesve një urë midis së kaluarës dhe së tashmes, duke frymëzuar respekt dhe dashuri për një popull dhe një kulturë të pasur.

"Jeta dhe puna juaj në Kosovë reflekton dashurinë autentike që keni për atë vend dhe popullin e tij." - Leah Hurwitz, udhëtare e turizmit etno-kulturor në Kosovë, 2023.


## TITUJ LIBRASH MBI ORENTIMIN DHE

- **Dizajnimi i jetës suaj**

*(Designing Your Life)*

Bill Burnett & Dave Evans

Një libër me një pikëpamje optimiste mbi ndërtimin e një karriere të suksesshme nga Bill Burnett dhe Dave Evans. Libri na shtyn të besojmë se çdo njeri do të gjejë qëllimin dhe kuptimin e tij/saj, pa marrë parasysh dallimet individuale. Poashtu ky libër mjaft i preferuar nga lexuesit sugjeron që lumturia në jetë dhe në punë është sekret i një karriere të suksesshme. E për të gjithë ata që ndjejnë ngecje në këtë aspekt, ky libër përfshin edhe disa hapa sugjerues që mund t'ju ndihmojnë ta gjeni lumturinë tuaj si në jetën personale, ashtu edhe në atë profesionale (Dalley, 2023).




- **Ji aq i mirë sa të mos mund të të injorojnë: Pse aftësitë e paraprijnë pasionin gjatë kërkimit të punës që duam**

*(So Good They Can't Ignore You: Why Skills Trump Passion in the Quest for Work You Love)*

Cal Newport

Newport e trajton çështjen e pasionit për karrierën në një mënyrë ndryshe. Newport ekspozon falsitetin e këshillës dhe besimit të përhershëm "ndjek pasionin" sepse pasioni do të të tregojë rrugën e duhur. Përkundrazi Newport tregon se kjo këshillë nganjëherë mund të jetë e rrezikshme dhe mund ta dërgojë personin deri në atë pikë ku do të ballafaqohet me ankthin. "So good they can't ignore" jep mesazhin e rëndësishëm se një karrierë e suksesshme nuk krijohet si pasojë e një pasioni të madh, por është pasioni ai që rrjedh nga puna e palodhshme dhe e fortë në një fushë të vlefshme. Në peshoren ku Newport e krahason pasionin dhe aftësitë, duket qartazi se aftësitë triumfojnë (Përkthyer dhe përshtatur nga Amazon.com).




- **Ndrysho drejtimin: Lëvizja jote e radhës është ajo që ka rëndësi**

*(Pivot: The Only Move That Matters Is Your Next One)*

Jenny Blake

"Pivot" është një nga librat më në zë nga Jenny Blake. Herët ose vonë në karrierë, për shkaqe nga më të ndryshmet, njeriu përballet me pasiguri dhe pyetje nëse karriera që po ndjek është e duhura apo jo. Këto faza psikologjike nganjëherë janë edhe të vështira për t'u kaluar dhe pikërisht këtu fokusohet libri "Pivot". Libri të mëson si ta gjesh përgjigjen tënde për karrierën që dëshiron ta ndjekësh, duke i patur parasysh aftësitë më të forta që një individ i posedon (Përkthyer dhe përshtatur nga Amazon.com). Për më shumë "Pivot" i jep lexuesit një rehati pasiqë libri përmban shembuj të njërive të tjerë që janë përballur me dilema dhe sfida të ngjashme, kështu duke e normalizuar nevojën për ndryshimin e karrierës (Sharma, 2023).




## ZHVILLIMIN NË KARRIERË

- **Karriera jolineare**

*(The Squiggly Career: Ditch the Ladder, Discover Opportunity, Design Your Career)*

*Helen Tupper & Sarah Ellis*

Është e mundur që karriera të cilën po e ndjekim po lëkundet, gjë e cila po ndodh shpesh kohëve të fundit për shkakë nga më të ndryshmet. Ky libër i shërben lexuesit pikërisht në rifitim të besimit në vetvetë dhe kalimin e fazës stresuese që pason e që mund të jetë shumë e ndërlikuar me raste. Të mjafton të gjesh motivin dhe pikat e tua të forta që të ndërtojnë një karrierë të re më të fuqishme dhe të suksesshme dhe kjo arrihet pasi lexuesi ka rastin të lexojë shembujt e shumë njerëzve të suksesshëm në këtë drejtim (Përkthyer dhe përshtatur nga Amazon.co.uk).




- **Rregullat e pathëna: Sekretet e një fillimi të mbarë**

*(The Unspoken Rules: Secrets to Starting Your Career Off Right)*

*Gorick Ng*

Për të gjithë ata që ndjehen të humbur në jetën e tyre profesionale, ose nuk e dinë se cila është rruga drejt suksesit në vendin e tyre të punës, "The unspoken rules" është libri i duhur për ta lexuar. "The unspoken rules" i shërben lexuesit si një udhëzues thelbësor që i zbulon sekretet se si të arrijnë një avancim në karrierë. Sekrete të pamësuara më parë në shkollë. Gorick Ng e bazon teorinë e tij në pesëqind intervista të bëra me persona, të cilët u përkasin industrive dhe profesioneve të ndryshme. Libri zbulon sekretet e një karriere të suksesshme në një kompani, sekrete që të ndihmojnë jo vetëm të mbijetosh, por edhe të shkëlqesh në vend të punës (Përkthyer dhe përshtatur nga Amazon.com).




- **Çfarë ngjyre ka parachuta juaj: Udhëzuesi juaj për një jetë me punë të vlefshme dhe karrierë të suksesshme**

*(What Color Is Your Parachute?: Your Guide to a Lifetime of Meaningful Work And Career Success)*

*Richard Nelson Bolles*

Për më shumë se pesëdhjetë vjet "What color is your parachute" e ka ndikuar mënyrën se si njerëzit mendojnë për gjetjen e punëve. Ky libër iu ka treguar miliona lexuesve si të përpilojnë një CV dhe letër motivimi, si të jenë me plot vetëbesim gjatë marrjes në intervistë dhe si të negociojnë për pagën më të volitshme. Pasi që tregu i punës po pëson ndryshime nga më të ndryshmet, njerëzit e kanë kuptuar se përballimi dhe menaxhimi i këtij ambienti varet nga kush janë ata, cilat janë interesat e tyre, ku dhe si e bëjnë punën më së miri dhe cila është mënyra më efektive për të shprehur aftësitë e tyre. Kjo pastaj bën që puna të jetë pjesë e një jete të mbushur plot me pasion dhe qëllim. Këshillat e "What color is your parachute" janë veglat që iu nevojiten njerëzve që po kërkojnë punë, apo atyre që duan të bëjnë një ndryshim në karrierë (Përkthyer dhe përshtatur nga Amazon.com).



# FAKTE ZBAVITËSE

Mesatarisht, një person shpenzon më shumë se 90,000 orë duke punuar, një numër që ka pësuar rritje drastike vitet e fundit.

Për çdo vend pune të shpallur, punëdhënësit marrin mesatarisht 118 aplikime.

Personat e grupmoshës 18-24 ndryshojnë vendin e punës 5.7 herë gjatë gjithë jetës së tyre.

Deri në vitin 2030, 85 milionë vende pune mund të mbeten të paplotësuara për shkak të mungesës së punëtorëve të kualifikuar, veçanërisht në fushën e teknologjisë.

94% e punonjësve thonë se do të qëndronin më gjatë në një kompani që investon në zhvillimin e karrierës së tyre.

77% e punëtorëve "remote" globalisht raportojnë se janë më produktivë kur punojnë nga shtëpia, duke përmendur që ndihen më pak të shpërqendruar dhe më të aftë në menaxhimin e kohës.

Puna "remote" ka ndihmuar në uljen e emetimeve globale të karbonit me rreth 54 milionë tonë metrikë në vit, pasi më pak njerëz udhëtojnë për në punë.

94% e punëdhënësve thonë se përvoja vullnetare është një faktor i vlefshëm në vendimet e punësimit, pasi ajo demonstroi lideritet, punë ekipore dhe një përkushtim për të mirën e shoqërisë.

Punonjësit që bëjnë punë vullnetare raportojnë nivel 20% më të lartë të kënaqësisë në punë dhe kanë më shumë gjasa të qëndrojnë me punëdhënësin e tyre aktual, duke dëshmuar se kompanitë përfitojnë nga promovimi i përgjegjësisë shoqërore.

Deri në vitin 2030, inteligjenca artificiale dhe automatizimi mund të zëvendësojnë deri në 30% të vendeve të punës në mbarë botën, por rolet e reja në zhvillimin e AI, robotikën dhe mbështetjen teknologjike pritet të rriten me 23%.

Industritë kreative – të tilla si krijimi i përmbajtjes, dizajni grafik dhe produktioni i muzikës po lulëzojnë, me një normë rritjeje pune prej 17% deri në vitin 2025.

36% e fuqisë punëtore globale tani është e përfshirë në punë të pavarur, të nxitur nga dëshira për pavarësi në karrierë dhe fleksibilitet për të zgjedhur projekte.

58% e punonjësve raportojnë se punëdhënësi i tyre ofron burime ndihmese të shëndetit mendor dhe kompanitë që e bëjnë këtë shohin një normë më të lartë të mbajtjes së punonjësve prej 21%.

63% e punonjësve besojnë se trajnimi i menaxherëve për të njohur shenjat e problemeve të shëndetit mendor dhe për të ofruar mbështetje përmirëson mirëqenien në vendin e punës dhe redukton stigmën rreth shëndetit mendor.

**"V-ja e kuqe"**, simboli ndërkombëtar i vullnetarizmit, u krijua me porosi nga **Margaret Bell, ish-presidentja e Volunteering Australia**, dhe iu dhurua **Volunteering Australia dhe IAVE** për t'u përdorur si simbol universal i vullnetarizmit.



FUN  
FACTS

# Bibliografia

Dalley, Mike. (2023, 19 tetor). 30 best career books to read (2024 reading list). Career Addict. Marrë më 13 dhjetor, 2024, nga <https://www.careeraddict.com/career-books>

How understanding European attitudes about volunteering can help associations. (2023). ASAE. [https://www.asaecenter.org/resources/articles/an\\_plus/2023/2-february/how-understanding-european-attitudes-about-volunteering-can-help-associations#:~:text=According%20to%20a%202018%20Eurostat,significantly%20higher%20in%20some%20countries.](https://www.asaecenter.org/resources/articles/an_plus/2023/2-february/how-understanding-european-attitudes-about-volunteering-can-help-associations#:~:text=According%20to%20a%202018%20Eurostat,significantly%20higher%20in%20some%20countries.)

Ndreçka, R. (2018). Përceptimi i studentëve mbi punën vullnetare. [Mikrotezë, Universiteti i Tiranës]. Academia.edu. [https://www.academia.edu/44150692/Perceptimi\\_i\\_Student%C3%ABve\\_Mbi\\_Pun%C3%ABn\\_Vullnetare](https://www.academia.edu/44150692/Perceptimi_i_Student%C3%ABve_Mbi_Pun%C3%ABn_Vullnetare)

Pivot: The only move that matters is your next one. (p.i.). Amazon.com: Books. Marrë më 13 dhjetor, 2024, nga <https://www.amazon.com/Pivot-Only-Move-That-Matters/dp/1591848202>

Popja, F. (2021, 20 shtator). Vullnetarizmi, vlerë e çmuar e solidaritetit. Elbasani Plus. <https://elbasaniplus.com/vullnetarizmi-vlere-e-cmuar-e-solidaritetit/30/>

Sharma, Nitesh. (2023, 19 janar). Mini book reviews- pivot: The only move that matters is your next one. Medium. Marrë më 13 dhjetor, 2024, nga <https://medium.com/@nitesh001/mini-book-reviews-pivot-the-only-move-that-matters-is-your-next-one-361b3aad5d2a>

So good they can't ignore you: Why skills trump passion in the quest for work you love. (p.i.). Amazon.com: Books. Marrë më 13 dhjetor, 2024, nga <https://www.amazon.com/Good-They-Cant-Ignore-You/dp/1455509124>

*The squiggly career: Ditch the ladder, discover opportunity, design your career.* (p.i.). Amazon.co.uk. Marrë më 13 dhjetor, 2024, nga <https://www.amazon.co.uk/Squiggly-Career-Ladder-Discover-Opportunity/dp/0241385849>

*The unspoken rules: Secrets to starting your career off right.* (p.i.). Amazon.com: Books. Marrë më 14 dhjetor, 2024, nga [https://www.amazon.com/Unspoken-Rules-Secrets-Starting-Career/dp/1647820448/ref=sr\\_1\\_1?crid=1QURMPCWM8OZO&dib=eyJ2JjoiMSJ9.sgU\\_rfGfkrD6dLxQgWpgQ.cdnviSbDNMBD95-Ncos8R3no-7cxUxinli3Y1yvQlb0&dib\\_tag=se&keywords=the+unspoken+rules+Gorick+ng&qid=1734195101&s=books&prefix=the+unspoken+rules+gorick+n%2Cstripbooks-intl-ship%2C214&sr=1-1](https://www.amazon.com/Unspoken-Rules-Secrets-Starting-Career/dp/1647820448/ref=sr_1_1?crid=1QURMPCWM8OZO&dib=eyJ2JjoiMSJ9.sgU_rfGfkrD6dLxQgWpgQ.cdnviSbDNMBD95-Ncos8R3no-7cxUxinli3Y1yvQlb0&dib_tag=se&keywords=the+unspoken+rules+Gorick+ng&qid=1734195101&s=books&prefix=the+unspoken+rules+gorick+n%2Cstripbooks-intl-ship%2C214&sr=1-1)

Wilson, J. (2012). Volunteerism research: A review essay. *Nonprofit and Voluntary Sector Quarterly*, 41(2), 176–212. <https://doi.org/10.1177/0899764011434558>

*What color is your parachute?: Your guide to a lifetime of meaningful work and career success.* (p.i.). Amazon.com: Books. Marrë më 14 dhjetor, 2024, nga <https://www.amazon.com/What-Color-Your-Parachute-Meaningful/dp/1984861204>

# Qendra e Zhvillimit të Karrierës (QZhK) përgjatë vitit të 17





UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
UNIVERSITY OF PRISHTINA

*Gëzuar Festat! / Season's Greetings!*

**QENDRA PËR ZHVILLIM TË KARRIERËS  
CAREER DEVELOPMENT CENTRE**



**2025**



UNIVERSITETI I PRISHTINËS  
"HASAN PRISHTINA"  
QENDRA PËR ZHVILLIM TË KARRIERËS

**Dhjetor, 2024**